

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7831 E hënë 25 Mars 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion **Ditës**

Politika e gjenocidit millosheviçian për shqiptarët e Kosovës ishte bërë një realitet tronditës. Konfliktet ishin kthyer në një fushë beteje, ku ushtria serbe kishte mësyre në... *Vijon në faqen 20*

Nga HAJRO LIMAJ
Kur Shqipëria përgatitej të ndërhynte në Kosovë



Opinion **Ditës**

Marrëveshja historike e 18 majit 2017 mes drejtuesve të dy partive kryesore të vendit, edhe pse e sulmuar dhe gati mallkuar praktikisht nga të gjithë në këto më pak... *Vijon në faqen 21*

Nga FATOS ÇOÇOLI

18 maji i dytë ose: E bën dot Feniksin?



Analiza e votave të 2015-ës nxjerr shumicë në popull PD-LSI

Sfida e Ramës për zgjedhjet, nga 10 bashkitë kryesore PS do të fitonte vetëm 2

Debati me Edi Ramën për listat, Gjylameti dorëhiqet nga PS e Tiranës?

Nëse ju në zgjedhjet e 30 qershorit fitoni një bashki të vetme më shumë se ne, ne jemi gati të shkojmë në zgjedhje të parakohshme parlamentare që në vjeshtë". Kështu u shpreh kryeministri Edi Rama dy ditë më parë, duke sfiduar hapur opozitën se për të shkuar te zgjedhjet e parakohshme parlamentare, më parë duhet...

Në faqet 2-3

PERFITUESIT NE 11 NJESITE ADMINISTRATIVE TE KRYEQYTETIT, LISTA E PLOTE

ALUIZNI: 1100 PERSONAT QE MARRIN TAPITE E SHTEPIVE

Banorët duhet të tërheqin lejet e legalizimit e më pas 'Agjencia' do të ndjekë procedurën. Dalin edhe listat e atyre që s'kanë paguar faturën



(Në foto) Foto ilustruese

Në faqet 6-7

REPORTAZHI

"RAI 2": Shqipëria nga droga e armët, te blerja e votave.

Rikthim tek Avdylajt

Në faqen 5

KAPEN 2 AUTORE

Vodhën me dhunë,

pronari i shtëpisë:

Jemi të frikësuar,

s'kemi mbrojtje

Në faqen 8

"LIFE PAGES"

Veronika Duci: Kur

nis psikoterapia.

Ylli Merja: Bimët

për osteoporozën

Suplement

DOSSIER

Hrushovi: Enveri

është një bandit,

u vinte litarin në

qafë dhe e tërhiqte

Në faqen 10-11

"Opozita e re', edhe me 139 deputetë Kuvendi është antikushtetues"

PD, Gjata: Meta, balancues i pushtetit pa fre të Ramës

Juristi: Kryeministri mund të shpallë monarki e sulltanat

Nga Valentina Madani

Opozita e sheh Ilir Metën si të vetmen portë, që sipas saj mund të ndalë revanshin e kryeministrit Edi Rama. Çlirim Gjata, sekretari për çështjet ligjore në Partinë Demokratike thotë për "Gazeta Shqiptare" se në



kushtet e krizës politike në vend, presidenti po mundohet të balancojë pushtetin pa fre të kryeministrit. Pavarësisht kësaj, juristi Çlirim Gjata shprehet se dorëheqja e z.Meta do të konfirmonte përfundimisht diktaturën në Shqipëri. Ndaj, ai flet...

Në faqen 4

ISSH: DOKUMENTET QE JU NEVOJITEN



Invalide të rinj, kushtet për të përfituar pension e masa që ju takon

Në faqen 9

ZGJEDHJET LLOGARITË

Analiza e votave të 2015-ës nxjerr shumicë në popull opozitën e re, PD-LSI

Sfida e Ramës për zgjedhjet vendore, ja votat që kanë dy koalicionet

Nga 10 bashkitë kryesore, PS-ja do të fitonte vetëm 2

Nëse ju në zgjedhjet e 30 qershorit fitoni një bashki të vetme më shumë se ne, ne jemi gati të shkojmë në zgjedhje të parakohshme parlamentare që në vjeshhtë". Kështu u shpreh kryeministri Edi Rama dy ditë më parë, duke sfiduar hapur opozitën se për të shkuar te zgjedhjet e parakohshme parlamentare, më parë duhet t'u vërtetonte shqiptarëve se ishte shumicë në vota. Natyrisht që ky është një bast i madh nga ana e Edi Ramës, kjo jo vetëm sepse tashmë ai është braktisur nga të gjithë aleatët e tij të dikurshëm me të cilët fitoi zgjedhjet e shkuara vendore, por edhe sepse gjendet në vitin 6 të qeverisjes. Natyrisht që një deklaratë e tillë duket se e ka bazën pikërisht të sondazhet e brendshme të Partisë Socialiste, por që bie ndesh me logjikën e numrave të votave që kanë prodhuar zgjedhjet pararendëse, qofshin ato lokale, ashtu edhe ato parlamentare. Kështu, nëse do të bënim një analizë të votave që kanë marrë partitë në 2015-ën për anëtarë të këshillave bashkiakë dhe do t'i mblidhnim sipas konfigurimit të tanishëm të koalicioneve, atëherë Partia Socialiste dhe aleatët e saj të vegjël do të ishin në një dizavantazh të thellë votash kundrejt opozitës aktuale, ku koalicioni të PD-së i janë shtuar edhe një sërë forcash të tjera si LSI, PDIU apo PDK, të cilat më parë ishin në koalicion me socialistët. Me këtë rikonfigurim të ri të koalicioneve, opozita në bazë të votave të 2015-ës ka mundësinë e madhe që jo vetëm të rimarrë bashkitë që fitoi në zgjedhjet e shkuara, por edhe të rivalizojë mazhorancën e majtë edhe në shumicën e bashkive që ajo drejton aktualisht, përfshi këtu edhe në disa bastione të saj. Në total nga 10 bashkitë e mëdha, PS në bazë të këtyre votave do të merrte vetëm 2, ndërsa do të humbte në 8 të tjerat. Natyrisht që ky rezultat merr të mirëqenë faktin se LSI, PDIU dhe PDK do t'i tërheqin votat e tyre në bilok në koalicionin opozitar, ku tashmë janë pjesë.

OPOZITA
Në bashkinë më të madhe dhe të rëndësishme në vend, pra atë të Tiranës, nëse zgjedhjet vendore do të prodhonin të njëjtin rezultat për subjektet politike si në 2015-ën, atëherë koalicioni i djathtë do të arrinte të shpallej fitues. Kjo, pasi Partia Socialiste së bashku me disa aleatë të saj të vegjël me të cilët ka krijuar koalicion së fundmi arrin të marrë 124000 vota kundrejt 155000 votave që kanë partitë e koalicionit të ri opozitar. Socialistët do të

humbnin edhe Bashkinë e Durrësit, nëse zgjedhjet e ardhshme lokale do të prodhonin të njëjtin rezultat në vota si në 2015-ën. Kjo, pasi në këtë bashki PS-ja së bashku me aleatët saj aktualë do të siguronte 38765 vota, ndërsa opozita e re 57907 vota. Opozita do të fitonte zgjedhjet edhe në Bashkinë e Elbasanit, Fierit dhe atë të Gjirokastrës. Kështu, nëse koalicioni i ri opozitar, pra PD, LSI, PDIU, PDK e ndonjë forcë tjetër më e vogël që i është bashkuar atij do të merrte njëjtin shumër

votash si në zgjedhjet e shkuara vendore edhe në Elbasan, atëherë edhe kjo bashki do të ndryshonte drejtim. Kjo, pasi PS-ja dhe koalicioni i saj do të kishte 29030 vota, kundrejt 41320 votave që do të siguronte opozita. Ndërkohë që në Bashkinë e Fierit do të kishim një rezultat të ngushtë, por në favor të opozitës. Koalicioni i PS-së do të merrte 31062 vota, ndërsa opozita 35141 vota. Një rezultat të ngushtë do të kishim edhe në Gjirokastrë, ku koalicioni i socialistëve do të kish-

te afërsisht 9 mijë vota kundrejt 11559 votave që do të merrte opozita. Po ashtu, opozita do të rimerrte sërish edhe bashkitë që i fitoi edhe në zgjedhjet e shkuara të 2015. Bëhet fjalë për Shkodrën, Lezhën dhe Kukësin. Në Shkodër raporti i votave do të ishte 17393 PS dhe 46 mijë vota opozita. Ndërkohë në Kukës PS-ja do merrte vetëm 10442 vota kundrejt 12550 votave të opozitës. Ndërsa në Lezhë, PS-ja do të merrte 15259 vota kundrejt 21124 votave të opozitës së re.

SOCIALISTËT
Nga ana tjetër, socialistët nga 10 bashkitë e mëdha të marra në analizë do të siguronin sërish fitoren vetëm në dy prej tyre. Dhe më konkretisht bëhet fjalë për Vlorën dhe Korçën. Në Vlorë PS së bashku me aleatët e rinj do të merrte 27829 vota kundrejt 21936 votave që do të merrte opozita. Po ashtu, socialistët do të fitonin edhe Bashkinë e Korçës. Në këtë bashki gjithmonë sipas rezultateve të 2015-ës, PS-ja do të siguronte 21524 vota kundrejt 19401 vo-



Kryeministri Edi Rama, gjatë kongresit të fundit të PS-së



Foto ilustruese

REZULTATI
Rezultatet e këtyre 10 bashkive kryesore janë pasqyra edhe asaj që ndodh me votat e koalicioneve në rang kombëtar. Kështu, koalicioni i PS-së në rang vendi do të merrte vetëm 587038 vota dhe ai i opozitës 825 mijë vota. Ndaj, në kushte të tilla duket se propozimi i Ramës i bërë gjatë mitingut të së shtunës i ngjan më shumë një blufi se sa një realiteti të mbështetjes, që gëzojnë të dyja kampet politike në popull.

Zgjedhjet e 2017-ës, raporti i votave mes dy koalicioneve

Ndërsa vota e 2015-ës e nxjerr opozitën e re shumicë në popull, nuk ndodh e njëjta gjë nëse në analizë do merrnim votat për zgjedhjet e parlamentare të 2017-ës. Ndryshe nga zgjedhjet vendore të 2015-ës, rezultati i zgjedhjeve parlamentare të 2017-ës u jep mundësi socialistëve të jenë sërish shumicë në vota, pavarësisht largimit nga koalicioni i tyre i Lëvizjes Socialiste për Integrim, Partisë për Drejtësi, Integrim dhe Unitet apo edhe PDK-së. Mbi bazën e shifrave zyrtare të KQZ-së rezultoi se pavarësisht se PDIU-ja dhe LSI-ja kanë kaluar në kampin opozitar, PS-ja e vetme është para me vota. PS-ja ka marrë në zgjedhje 764.750 vota, ku nuk pati koalicione dhe ku të gjitha partitë poli-



tike garuan si subjekte më vete. PD-ja rezultoi me vetëm 456.413 vota, ndërsa dy partitë tashmë në koalicionin e

Votat e zgjedhjeve parlamentare të 2017-ës në rang vendi	
PD	456.413 vota
LSI	225.901 vota
PDIU	76.069 vota
Koalicioni opozitar, në total	758.383 vota
Partia Socialiste	764.750 vota

djathtë rezultuan, LSI-ja me 225.901 vota dhe PDIU-ja me 76.069 vota. Ndaj, nëse mblidhim votat e PD-së, LSI-së

VOTAT PËR KËSHILLIN BASHKIAK	
BASHKIA TIRANË	PS - 124000 vota Opozita - 155000 vota
BASHKIA VLORË	PS - 27829 vota Opozita - 21936 vota
BASHKIA SHKODËR	PS - 17393 vota Opozita - 46 mijë vota
BASHKIA DURRËS	PS - 38765 vota Opozita - 57907
BASHKIA ELBASAN	PS - 29030 vota Opozita - 41320 vota
BASHKIA FIER	PS - 31062 vota Opozita - 35141 vota
BASHKIA GJIROKASTËR	PS - 8928 vota Opozita - 11559 vota
BASHKIA KORÇË	PS - 21524 vota Opozita - 19401 vota
BASHKIA KUKËS	PS - 10442 vota Opozita - 12550 vota
BASHKIA LEZHË	PS - 15259 vota Opozita - 21124 vota
VOTAT E KOALICIONEVE NË 2015 NË RANG VENDI	Koalicioni i PS - 587038 vota Koalicioni i PD - 825 mijë vota



Në prag të zgjedhjeve të ardhshme vendore (nëse ato do të mbahen në 30 qershor) Partia Socialiste e kryeqytetit është përfshirë në një debat të brendshëm. Protagonistë duket se janë bërë vetë kryeministri Edi Rama dhe kryetarja e PS-së së Tiranës, Blerina Gjylameti. Dhe shkak raportohet se është bërë pikërisht lista e 100 kandidatëve për anëtarë të Këshillit Bashkiak të Tiranës. "News Bomb" ka raportuar dje se mes kreut të qeverisë dhe kryetares së PS-së së Tiranës ka pasur pas mitingut në sheshin "Nënë Tereza" një debat të ashpër, kjo pasi Gjylameti është ankuar në lidhje me përbërjen e kësaj liste. Mesa duket, në listë nuk kishte emra të ekipit të Blerina

Debati me Ramën për listat, Gjylameti dorëhiqet nga PS e Tiranës?



Gjylametit dhe kjo e fundit ka pretenduar se nuk është pyetur rreth përbërjes së listës së bërë publike dje në takimim ku u prezantua

edhe Veliaj si kandidat për kryetar bashkie. Sipas "News Bomb" debati ka shkuar deri aty sa Gjylameti ka dhënë edhe dorëheqjen

nga posti që mban prej gati viti e gjysmë, që pas largimit nga PS-ja të Sammir Tahirit. E pyetur rreth këtij lajmi nga "Gazeta Shqiptare", Blerina Gjylameti nuk ka preferuar të përgjigjet, duke mos e hedhur poshtë, por as duke e konfirmuar dorëheqjen. Ndërkohë që burime pranë selisë rozë kanë konfirmuar debatin rreth kësaj çështjeje jo vetëm gjatë mitingut, por edhe më parë lidhur me listën. Gjithsesi, këto burime nuk kanë konfirmuar dorëheqjen e Gjylametit, por as nuk e kanë hedhur poshtë një gjë të tillë.

Gjykata ka lënë në burg Mariglen Doçin, Dorian Protoduarin dhe Emiljan Mustafën

Burg për protestuesit, PD: Qeveria po përpiqet të trembë qytetarët

Tre protestues të tjerët u lanë në "arrest shtëpie"

Gjykata e Tiranës ka lënë në burg tre nga gjashtë të arrestuarit në protestën e fundit të opozitës, të organizuar para Kuvendit të Shqipërisë, konkretisht Mariglen Doçin, Dorian Protoduarin dhe Emiljan Mustafën. Tre të tjerët, Jurgen Gjikota, Bledar Dollia dhe Arbër Kola u lanë në "arrest shtëpie". Sena u zhvillua dje me dym të mbyllura, ndërsa morën pjesë në të familjarë dhe përfaqësues nga PD dhe LSI. Të arrestuarit akuzohen për konsumimin e elementëve të veprave penale "Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik", "Goditje për shkak të detyrës" dhe "Prishja e qetësisë publike". Jashtë gjykatës ish-deputetët e opozitës e cilësuan një vendim politik. Ish-deputeti i PD-së, Edmond Spaho, duke folur pas seancës gjyqësore akuzoi mazhorancën se nëpërmjet këtyre vendimeve po përpiqet të trembë protestuesit. "Për tre të ndaluar u vendos 'arrest me burg' pa fakte dhe prova. Shqipëria është ndoshta i vetmi vend në Europë që burgos kur proteston për të drejtat e tua. Qëllimi i prokurorisë dhe gjykatës është të dalë në mbrojtje të mazhorancës, me synim se do të trembë protestuesit në protestat e ardhshme, që do të organizohen kundër kësaj qeverie dhe Edi Ramës. Por, janë të pashpresë në këto përpjekje që bëjnë, sepse kur qytetarët



Ish-deputeti i PD-së, Edmond Spaho

SPAHO

"Qëllimi i prokurorisë dhe gjykatës është të dalë në mbrojtje të mazhorancës, me synim se do të trembë protestuesit në protestat e ardhshme, që do të organizohen kundër kësaj qeverie dhe Edi Ramës. Por janë të pashpresë në këto përpjekje që bëjnë, sepse kur qytetarët përplasen me qeverinë, në marrë për protestuesit. "Për Dorian Protoduarin ju them me bindje të plotë që as nuk ka qenë gjatë protestës, ka qenë me një nga kameramanit. Nuk ka qenë fare te pjesa ku pati shtyrje me policinë. Akt i turpshëm politik që i kthen këto gjykata në ambiente të PS, nuk mund të quhen gjykata. Edi Rama i shpalli sot 'luftë' 'Unazës së Re' me këtë vendim të turpshëm ndaj Dorian Protoduarit dhe ne ashtu do të përgjigjemi. Do të të ndjekim se je në kafe, se je në restorant, se je në takime dhe

do të protestojmë ndaj teje. Po deshe na fut në burg të gjithëve, se edhe po na fute në burg, protesta do të vazhdojë dhe nga burgu. Nuk do të na ndalësh dot", - tha Balliu. Ndërsa deputeti i LSI-së, Endrit Brahimllari u shpreh se edhe një herë gjykatat faktuan se dënojnë të pambrojturit dhe lënë të lirë të fortë dhe ata që janë të lidhur me pushtetin. "Është e qartë se është një ndalim, por edhe gjykim politik. Tanimë kjo është e dukshme jo vetëm për masat e marra sot, por për të gjithë protestuesit. Jetojmë në një vend ku kemi të bëjmë me një qeveri, e cila është e kapur totalisht nga krimi i organizuar. Është e kapur totalisht duke vjedhur hapur tek Unaza e Re dhe ndalohen dhe arrestohen protestues, të cilët protestojnë për shtëpitë e tyre, pronën e tyre dhe sot janë të lirë Edi Rama, Damian Gjikonuri, Afrim Qendro, që kërkonin t'i prishnin shtëpinë Dorjanit dhe banorëve të tjerë të 'Unazës së Re' për të gllabëruar 40 milionë euro", - u shpreh ish-deputeti i LSI-së, Endrit Braimllari. Shoqërimi i protestuesve bëri që protesta e opozitës të zhvendoset nga parlamenti në drejtim të Drejtorisë së Policisë së Tiranës. Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi dhe ish-deputeti i PD-së, Flamur Noka thanë se policia nuk kishte arsye për t'i shoqëruar, për shkak se protesta ishte tejet paqësore.

SHKURTE

PD: Veliaj bëhet gati për ndërtimin e kullave te Parku i Liqenit

Partia Demokratike akuzoi dje kryetarin e Bashkisë së Tiranës se ka në plan të betonizojë pjesën e Gardës së Republikës, në afërsi të Parkut të Madh të Liqenit. Zëdhënësjë e Partisë Demokratike, Ina Zhupa, deklaroi se Erion Veliaj ka shpallur tenderin për ndërtimin e një rruge me gjatësi 650 metra që lidh zonën e Gardës me Rrugën e Kosovarëve, "duke ndërtuar ekskluzivisht një rrugë të re për kullat që do të ndërtohen aty më vonë, pas prerjes së qindra pemëve, për gjoja ndërtimin e rrugës". Ajo vijon më tej duke thënë se aty do të ndërtohen kulla mbi 29 metra lartësi dhe mbi 9 kate, me shërbime, parking dhe banim. "Zona te Garda e Republikës nuk i kthehet Parkut të Liqenit Artificial, por bashkia po bën gat infrastrukturën për kullat private që do të ndërtohen në këtë zonë. 4 ditë përpara shpalljes së rikandidimit të tij luksoz, që sipas mediave ka kushtuar më shumë se 1 milion euro, Erion Veliaj ka shpallur tenderin për ndërtimin e një rruge me gjatësi 650 metra. Rruga nuk ka ndonjë vlerë të shtuar për qytetin, por ajo do të marrë rreth 2 milionë euro nga taksat e qytetarëve për t'u shërbyer klientëve të Ramës dhe Veliaj. Ajo lidh zonën e Gardës me Rrugën e Kosovarëve, duke ndërtuar ekskluzivisht një rrugë të re për kullat që do të ndërtohen aty më vonë, pas prerjes së qindra pemëve, për gjoja ndërtimin e rrugës. Oligarkët do ta kenë rrugën të hapur për të ndërtuar kulla mbi 29 metra lartësi dhe mbi 9 kate, me shërbime, parking dhe banim", - tha Ina Zhupa.

Veliaj nis fushatën: Njëqind ditë sprint deri në fitoren e dytë

Një fundjavë ndryshe, afër natyrës dhe ushqimit bio të zonës, por jo larg kryeqytetit! Kërraba mikpritit sot dhjetëra qytetarë të ardhur nga Tirana dhe zonat përreth për të festuar ardhjen e pranverës, përmes një sërë aktivitetesh që promovojnë natyrën, vlerat agroturistikë të zonës, si dhe nxisin qytetarët që të konsumojnë sa më shumë prodhimet të vendit, si mënyrë e mirë për të ndihmuar ekonominë lokale. Festës iu bashkua edhe kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, i cili falënderoi Kërrabën për mikpritjen dhe u shpreh se ky është një ogur i mirë edhe për zgjedhjet e ardhshme vendore të 30 qershorit. "Është gjithmonë kënaqësi të vij në Kërrabë. E para, se fushata më ecën mbarë. Kështu e nisa edhe herën e fundit dhe shkoj perfekt. Jam i bindur se kështu do shkojë edhe kësaj here", - tha Veliaj. Ai ftoi banorët e Kërrabës që t'i bashkoheshin sprintit të këtyre 100 ditëve për të bërë të mundur me votën e tyre vazhdimin e zhvillimit të Tiranës dhe të ekonomive të tyre rurale. "Fillojmë me këtë takim madhështor 100 ditësh sprint, deri në datën 30 qershor. Ndaj, edhe gjithë vëllezërit dhe motrat që janë demokratë apo kanë bindje të tjera, duam t'ju themi që ne ju duam shumë, do t'ju shërbejmë njësoj, sepse besoj që Tirana është vend për të gjithë", shtoi Veliaj.

KRIZA POLITIKE

INTERVISTA

Valentina Madani

Opozita e sheh Ilir Metën si të vetmen portë, që sipas saj mund të ndalë revanshin e kryeministrit Edi Rama. Çlirim Gjata, sekretari për çështjet ligjore në Partinë Demokratike thotë për "Gazeta Shqiptare" se në kushtet e krizës politike në vend, presidenti po mundohet të balancojë pushtetin pa fre të kryeministrit. Pavarësisht kësaj, juristi Çlirim Gjata shprehet se dorëheqja e z.Meta do të konfirmonte përfundimisht diktaturën në Shqipëri. Ndaj, ai flet për mundësitë e një zgjedhjeje së një presidenti të ri, në rast të dorëzimit të mandatit nga z.Meta: "Mazhoranca aktuale nuk ka lënë gjë pa bërë deri tani e mund të zgjedhë jo president, por mund të shpallë edhe monarki, ose sultanat, pasi duket që kjo i pëlqen më shumë kryeministrit tonë. Vetëm demokraci nuk mund të bëjë kjo mazhorancë. Nuk mundet hajdutët të bëhen zotërinj. Ata mund të vishen si të tillë, por nuk janë". Përsa i përket "opozitës së re" në Kuvend, z.Gjata është i qartë kur shprehet: "Edhe me 139 deputetë, Kuvendi është antikushetues. 140 mandateve u duhen vënë 140 emra deputetësh, dhe të kundërt vjen në kundërshtim me Kushtetutën. Sado të mundohet Edi Rama t'i zëvendësojë, nuk i bën dot 140, pasi ka shumë kandidatë nga listat që nuk e pranojnë mandatin".

Z.Gjata, pse kjo situatë kaq e tensionuar mes opozitës dhe opozitës, kur kjo e fundit ka dalë jashtë institucioneve dhe po proteston në sheshet e Shqipërisë?

Sepe ka rënë shteti, ka rënë Kushtetuta. Pushtetin në Shqipëri e ka marrë mafia e drogës me në krye kryeministrin. Ky i fundit ka kapur çdo lloj pushteti dhe po i kontrollon me autoritet të hekurit, madje më shumë ato kompetenca dhe pushtete që nuk i takojnë. Përpara shoqërisë shqiptare dhe opozitës si përgjegjësi politike ka dalë një mision i madh për të mos e lejuar këtë. Ndryshe, gjithçka merr fund dhe Shqipëria kthehet në një tokë të zbrazur.

Si mund të zgjidhet konfliktualiteti mes palëve dhe si e gjykoni qëndrimin kritik të ndërkombëtarëve lidhur me dorëzimin e mandateve të opozitës?

Nuk ka më palë që kur opozita dorëzoi mandatet. Kemi një qeveri të mafias dhe popullin përballë saj, pra një konflikt sa social, aq edhe politik. Për sa i takon qëndrimin kritik të ndërkombëtarëve lidhur me dorëzimin e mandateve, nuk e di se cili quhet qëndrim kritik: ai Departamentit Amerikan të Shtetit ku konstaton mafien në pushtet, deklaratat e ambasadorëve në Tiranë, apo median ndërkombëtare të panumërt në pasqyrimin e protestave tona dhe komentet mbi gjynahet e qeverisë. Ndërkohë, zgjidhja është e thjeshtë, largimi i kësaj qeverie dhe këtij regjimi dhe hapja e rrugës për zgjidhjen politike.

Cfarë ndodh nëse Edi Rama nuk do të dorëhiqet nga posti i kryeministrit?

Do të largohet nga qytetarët. Sa të mundshme janë dy palë zgjedhje njëherësh, ato lokale dhe të parakohshme? Nuk është problemi a janë të mundshme. Janë plotësisht të zgjidhshme politiktisht. Këtu pastaj hyn teknika.

Nëse realisht Shqipëria do të bëjë zgjedhje të parakohshme, a besoni se opozita do t'i fitojë ato?

Kjo është një pyetje luksi. Çdo opozitë hyn në zgjedhje për t'i fituar dhe aktualisht është në nivel jashtëzakonisht të lartë në këtë situatë. Por, imediatë tani për tani nuk

"Opozita e re", juristi: Edhe me 139 deputetë, Kuvendi është antikushetues

PD, Gjata: Meta, balancues i pushtetit pa fre të Ramës

"Kryeministri mund të shpallë monarki e sultanat"



Çlirim Gjata, sekretari për çështjet ligjore në Partinë Demokratike

është kush i fiton zgjedhjet, por kthimi i demokracisë, kthimi i Kushtetutës, duke larguar regjimin mafioz në pushtet dhe pas këtyre, shtrimi i rrugës për zgjedhje të lira e të ndershme me një sistem dhe ligj zgjedhor të duhur, pa kriminelë që t'i blejnë ato.

Paralajmërimi i presidentit se është gati të dorëzojë mandatin me qëllim zgjidhjen e krizës, e thellon apo e shtyn atë drejt zgjidhjes?

DEPUTETËT E RINJ

"Edhe me 139 deputetë, Kuvendi është antikushetues. 140 mandateve u duhen vënë 140 emra deputetësh, në të kundërt vjen në kundërshtim me Kushtetutën. Sado të mundohet Rama t'i zëvendësojë, nuk i bën dot 140, pasi ka shumë kandidatë nga listat që nuk e pranojnë mandatin. Gjithsesi edhe me këtë mënyrë zgjedhjeje, emërimi i opozitës së re është antikushetues, pasi nuk mund të zëvendësohen 'en-bloc', sepse nuk janë të votuar", tha z.Gjata.

Presidenti po mundohet të balancojë, me aq sa mundet, pushtetin pa fre të kryeministrit dhe mendoj se po bën një punë të mirë. Një qeveri e lidhur me trafikun e drogës, që ka kapur të gjitha pushtetet, madje më shumë atë që nuk i takon. Jemi drejt një junte, pasi është prishur balanca e shtetit. Rama ka kapur prokurorinë, e cila nuk po heton vjedhjen e zgjedhjeve nga krimi. Meta është politikan me shumë përvojë dhe është bërë shkak për dy rrotacione të buta push-

teti. Meta është e vetmja portë që mund të ndalin revanshin e kryeministrit. Një mafie droge po vendos një juntë.

Nëse z.Meta lë mandatin dhe vendi mbetet pa parlament edhe pa president, cfarë ndodh juridiktisht?

Në këtë situatë nuk ka çështje juridike. Jua thashë, shteti ka rënë, Kushtetuta ka rënë. Prandaj ka vetëm zgjidhje politike, që çojnë në rregullime juridike. Dorëheqja e z.Meta do të konfirmonte përfundimisht diktaturën në Shqipëri.

A mund ta zgjedhë mazhoranca aktuale presidentin e ri?

Mazhoranca aktuale nuk ka lënë gjë pa bërë deri tani e mund të zgjedhë jo president, por mund të shpallë edhe monarki, ose sultanat, pasi duket që kjo i pëlqen më shumë kryeministrit tonë. Vetëm demokraci nuk mund të bëjë kjo mazhorancë. Nuk mundet hajdutët të bëhen zotërinj. Ata mund të vishen si të tillë, por nuk janë.

Gjykoni se e është nevojshme që dorëheqja e presidentit, në këtë rast e z.Meta, të kalojë për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese?

Dorëheqja nuk kalon nga Gjykata Kushtetuese. Shkarkimi duhet të kalojë detyrimisht nga Gjykata Kushtetuese.

Kushtetuta e republikës përçakton që Kuvendi ka 140 deputetë, a mund të jetë legjitim një parlament me 99 deputetë?

Edhe me 139 deputetë Kuvendi është antikushetues. 140 mandateve u duhen vënë 140 emra deputetësh. Në të kundërt vjen në kundërshtim me Kushtetutën. Sado të mundohet Edi Rama t'i zëvendësojë, nuk i bën

dot 140 pasi ka shumë kandidatë nga listat që nuk e pranojnë mandatin. Gjithsesi, edhe kjo mënyrë zgjedhjeje, emërimi i opozitës së re është antikushetuese, pasi nuk mund të zëvendësohen 'en-bloc', sepse nuk janë të votuar.

Po përsa u përket komisionerëve të KZAZ-ve, cfarë ndodh tani që ka kaluar afati? Përmes këtij vendimi a po paralajmëron opozita bojkotin e zgjedhjeve lokale?

Është thjesht problem teknik. Gjithmonë është rregulluar, me vonesë, por është rregulluar. Tani për tani nuk ka komisionerë nga opozita, sepse nuk mund të ketë zgjedhje në këto kushte. Pa u plotësuar kushtet e vëna, nuk ka zgjedhje.

A mund të ketë zgjedhje pa opozitën, siç ka paralajmëruar PS-ja dhe OSBE-ja në rast bojkoti?

Përsa i takon Partisë Socialiste, çështja atje është shumë më e ndërlikuar se ç'duket. Nuk po merret vesh ku mbaron qeveria e ku fillon PS-ja. Ndërsa për OSBE-në, nuk besoj se është në misionin e saj ta kthejë

AKUZA

"Mazhoranca aktuale nuk ka lënë gjë pa bërë deri tani e mund të zgjedhë jo president, por mund të shpallë edhe monarki, ose sultanat, pasi duket që kjo i pëlqen më shumë kryeministrit tonë. Vetëm demokraci nuk mund të bëjë kjo mazhorancë. Nuk mundet hajdutët të bëhen zotërinj. Ata mund të vishen si të tillë, por nuk janë", tha sekretari për çështjet ligjore në PD.

Shqipërinë 30 vite pas, në sistemin monist.

Prej disa ditësh PD-ja ka publikuar përgjime zyrtare për çështjen "Babale", përmes të cilave denoncoi për përfshirjen e zyrtarëve të lartë të PS-së. Për cfarë bëhet fjalë konkretisht?

Prokuroria në shkelje të ligjit nuk ka zbardhur disa përgjime, ku dëshmitari i sajuar flet për Taulant Ballën dhe për drejtorin e përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Pas publikimeve të përgjimeve zyrtare, prokuroria duhet të merrte të pandehur Taulant Ballën, Fatmir Xhafajn, Ard Velinun, Albert Nushin dhe një sërë strukturash policore, që kanë shërbyer për manipulimin e ngjarjes, me qëllim shpëtimin e pushtetit të Ramës dhe dënimin e opozitës që denoncoi aferën. Përgjimet zyrtare të prokurorisë faktikisht se pushteti kriminal i Edi Ramës e sajoi dëshmitarin e rremë dhe e pagoi atë për të shpëtuar veten dhe për ta përdorur kundër opozitës. Përgjimet faktikisht që prokuroria në shkelje të ligjit nuk ka zbardhur disa përgjime, ku dëshmitari i sajuar flet për Taulant Ballën dhe drejtorin e përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Gazetari: "Doktori" hodhi poshtë shifrat e kreut të policisë

"RAI 2": Shqipëria nga blerja e votave, te droga dhe armët

Rikthimi tjetër në qendrën e Avdylajve

Protestat e opozitës dhe situata e krijuar në Shqipëri kanë sjellë këtu një grup xhirimi të "TG2", të cilët kanë bërë edhe një reportazh për trafikun e armëve dhe drogës, pjesë e rubrikës "Dossier" në "Rai 2". Reportazhi i gazetarit Leonardo Zelino zgjat 47 minuta dhe mban titullin "Shqipëria, rajoni 21-të i Italisë". Reportazhi nis me Iglin nga Shijaku, një person që flet me shpinë dhe tregon një kallashnikov dhe një sasi droge, të cilat trafikohen më pas drejt Italisë. Ndërsa tregon mënyrën se si shkojnë në Itali, ai thotë se kjo armë përdoret për të mbrojtur plantacionet e marijuanës, por edhe për të vvarë njerëzit, nëse është e nevojshme. Ndërsa drogën, plot 10 kg e mban në shtëpi që ta provojnë klientët. Reportazhi bën më pas një histori të shkurtër të Shqipërisë, vendit të shqiponjave, që pas rënies së regjimit komunist nisi të çonte emigrantë në brigjet italiane përmes Adriatikut, për t'u kthyer më pas në rrugë trafiqesh, që nis me cigaret dhe vazhdon me trafikun e drogës. "Nëse kontrabanda mori një goditje të fortë në vitet 2000, trafiku i drogës nuk është ndalur asnjëherë, madje Adriatiku është bërë autostrada e trafikantëve. Sipas raportit të Europol 2017, Shqipëria është laborator i kryesor për kultivimin dhe trafikimin e marijuanës. Për kontinentin e vjetër, ajo është një lloj Kolumbie e drogës", - citohet në reportazhin e "Rai 2". Në luftë me kanabisin përmendet operacioni i ndërhyrjes së policisë në Lazarat, gjë e cila ndonëse e largoi që aty, bëri që kultivimi të përhapet në të gjithë territorin e vendit. Për rezultatet e arritura ka folur edhe drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Ardi Veliu, sipas të cilit shifrat e 2018-ës janë më të mirat e 30 viteve të fundit. Veliu thotë se janë gjetur vetëm pak plantacione, ndërsa janë bërë qindra orë fluturime së bashku me GDP dhe janë gjetur vetëm 600 rrënjë të kultivuara. Gazetari italian i ka shkruar në zyrë ish-kryeministrin Sali Berisha. Ai thotë se "Doktori" hodhi poshtë shifrat e kreut të policisë. "Importi i bananeve është dhjetëfishuar. Brenda kontenerëve të bananeve ose ka banane, ose ka diçka tjetër", - thotë Berisha. Sipas tij, "nëse plantacionet në fusha janë pakësuar, janë shtuar ato në sera, pasi çdo javë tonelata të tëra shkojnë në Itali, në Turqi, Greqi për t'u sh-



këmbyer me heroinë". Ndërkohë citohen edhe autoritetet italiane, të cilat thonë se shqiptarët kanë marrë lidhshpinën e drogave të forta në Europë. Më pas gazetaret rikthehen në Shijak, zonën që e konsiderojnë si vendin e Avdylajve, një grup kriminal që u godit pak pas zgjedhjeve të 2017-ës. Dosieri nxjerr në pah edhe përgjimet e prokurorisë për vëllëzërit Avdylaj, që telefonohen nga kryebashkiaku i Durrësit, Vangjush Dako, për ta falënderuar për votat e mbledhura në zgjedhje. Më pas, njeriu që kanë zgjedhur, trafikanti i drogës, Iglu, thotë se me drogë bëhen para dhe me para blihen vota. "A ndodhi kështu në zgjedhjet e fundit? Kështu do të ndodhte edhe në zgjedhjet e ardhshme", - thotë ai. Dokumentari përqendrohet më pas te protestat e opozitës, largimet e ministrave të Brendshëm, Saimir Tahiri dhe Fatmir Xhafaj, për shkak të problemeve të familjarëve, por edhe akuzave për drogën. Reportazhi vazhdon me zërin e protestuesve që s'kanë më besim të qeveria, e cila sipas tyre arrin t'i blejë zgjedhjet dhe te dek-

larat e kreut të PD-së, Lulzim Basha; ish-deputetit Agron Shehaj etj. "Zgjedhjet u blenë. Raporti i ministrave teknikë përpara zgjedhjeve të fundit e thotë këtë gjë. Tani ka prova të prokurorisë që këtë e bëri qeveria e Partisë Socialiste me bashkëpunimin me bandat kriminale. Nuk mund të ketë stabilitet pa demokraci dhe shtet të së drejtës", - thotë Lulzim Basha. Më tej citohet edhe kryeministri Rama: "Rregullat në demokraci janë të qarta. Është populli ligji. Ka një mandat për ta respektuar dhe nuk mund të vihet në diskutim nga minoranca, që ka të gjitha të drejtat të diskutueshme se çfarë mendon, por nuk ka të drejtë të imponojë asgjë", - përgjigjet kryeministri Edi Rama. "Blerja e votës? Po, ka ekzistuar ashtu siç ka në Itali, apo në vende të tjera, por që blerja e votës të vendosë zgjedhjet, kjo nuk ekziston", - thotë Rama. Një opinion për situatën politike ka dhënë edhe gazetari Artur Zhejli, po ashtu një dëshmi të tijen ka dhënë edhe analisti Fatos Lubonja. Ky i fundit tregoi historinë e tij se si u dënua gjatë regjimit vetëm se shkruante poezi.

Presidenti grek, mesazh Shqipërisë: Çështja çame, pengesë për në BE

GREQI Në fjalën përsëritëse për festën kombëtare të kryengritjes greke së 1821-shit kundër Perandorisë Otomane, presidenti grek Prokopis Pavlopulos i ka dërguar një mesazh të hapur Shqipërisë, Maqedonisë Veriore, në kuadrin e zbatimit të marrëveshjes së Prespës; Turqisë për zhvillimet e fundit në rajon si dhe është referuar në çështjen e Qipros. Në mesazhin e tij për Shqipërinë, presidenti Pavlopulos ka përsëritur qëndrimin e paraqitur vazhdimisht kohë e fundit, duke theksuar konkretisht: "Për sa i përket Shqipërisë fqinje, nuk jemi kundër perspektivës europiane të vendit. Çfarë parashikon si kusht bazë e logjik respektimin e sinqertë të së Drejtës Europiane dhe Ndërkombëtare, domethënë respektimin e shtetit të së drejtës dhe të gjitha të drejtave themelore të njeriut. Kështu, trajtime të ngjashme me të fundit kundër minoritetit etnik grek, të cilat zhvlehtësojnë dhunshëm vlerën e jetës së njeriut ose nënvlerësojnë hapur të drejta bazë si e drejta e pronës, përbëjnë një pengesë të pakapërcyeshme për perspektivën pa bllokada të Shqipërisë. Pengesë përbën edhe çdo pretendim krejt pa bazë, gjoja "të drejtash" të çamëve shqiptarë, bashkëpunëtorë të egër të nazimit, siç është vërtetuar dhe historikisht". Mesazhi i presidentit Pavlopulos u dha në Kalamata, ku ndodhej për festën kombëtare dje. Ndërkohë, gjatë parakalimit të nxënësve në qendër të Athinës, një turmë njerëzish kanë protestuar kundër marrëveshjes së Prespës, duke shkaktuar episode të vogla. Policia ka shpërndarë në rajonin policor dy prej protestuesve, por pa vijuar me ndjekje ligjore. Në parakalimin zyrtar në Athinë, 1500 policë do të mbrojnë zonën, duke krijuar një rrjet të padepërteshëm rreth qeveritarëve dhe zyrtarëve të lartë, nga episode të mundshme kundër marrëveshjes së Prespës.



PHILIP MORRIS ALBANIA Shpk

Njoftim se duke filluar nga data 27 Mars 2019 çmimi maksimal i shitjes me pakicë për 1 paketë për produktet e mëposhtme është si vijon:

Përshkrimi i Produktit	Çmimi prej datës 27.03.2019 (përfshirë TVSh-në)
MARLBORO PREMIUM BLACK KS BOS 20	500 Lekë/paketë
MARLBORO GOLD (2.0 ORIGINAL) KS LCB 20	320 Lekë/paketë
MARLBORO GOLD (2.0 ORIGINAL) KS BOX 10	160 Lekë/paketë
MARLBORO (RED FWD) KS BOX 20	320 Lekë/paketë
MARLBORO (RED FWD) KS BOX 10	160 Lekë/paketë
MARLBORO FLAVOR PLUS (FWD) KS SRP 20	320 Lekë/paketë
MARLBORO TOUCH (4 MG) KS RCB 20 SLI	300 Lekë/paketë
MARLBORO TOUCH (6 MG) KS RCB 20 SLI	300 Lekë/paketë
MARLBORO TOUCH XL (2.0) 100 RCB 20 XSL	300 Lekë/paketë
MARLBORO TOUCH XL (2.5) 100 DSP 20 SSL	280 Lekë/paketë
PHILIP MORRIS QUANTUM SUPREME KS BOX 20	260 Lekë/paketë
PHILIP MORRIS QUANTUM SUPREME KS RCB 10	130 Lekë/paketë
PHILIP MORRIS SLIMSMAG 100 RCB 20 XSL	240 Lekë/paketë
PHILIP MORRIS COMPAC6M KS RCB 20 SLIMS	240 Lekë/paketë
PHILIP MORRIS COMPAC4 KS RCB 20 SLIMS	240 Lekë/paketë
MERIT BIANCA 100 BOX 20 SSL	220 Lekë/paketë
MERIT (ORANGE) KS RCB 20	230 Lekë/paketë
L&M RED LABEL KS RCB 20	220 Lekë/paketë
L&M LOFT 4MG RCB 20	220 Lekë/paketë
L&M LOFT 6MG RCB 20	220 Lekë/paketë
L&M LOUNGE (6MG) 100 DSP 20 SSL	200 Lekë/paketë

Njoftimi bëhet në përputhje me Udhëzimin nr. 2, datë 28.1.2010 të Ministrisë së Financave "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 17, datë 13.5.2008 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar" (i ndryshuar).

PHILIP MORRIS ALBANIA Shpk

Rr. Murat Toptani , Qendra e biznesit Eurocol, Kati i 10, 1000 Tirana, Albania
Tel: +355 42 276 670

Shitje me Ankanë të dyle nga Studio Permbairmore L.D.C

"Trulli + ndërtesa" me nr. pasurisë 286/5/1, vol. 3, faqe 36, Zona Kadastrale, 3866, me sipërfaqe totale 300 m², regjistruar në Z.V.R.P.P. Tirane. Çmimi fillestar për shitje është 1.800.000 Leka.
Data e shpalljes 27.02.2019
Data e zhvillimit 28.03.2019 deri në orën 16.00

Ankandi zhvillohet në ambientet e Studios Permbairmore L.D.C me adresë Rruga "Myslym Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tirane.

Table with 3 columns: Name, Number, and Second Number. Contains a list of names such as ARBEN REXHEP BUSHI, MUHARRREM BRAHIMI, MUSA QAZIM VLADI, etc., with corresponding numbers in each column.

Policia: Klejdi Saliq dhe Arbër Muçaj, të dënuar më parë në Greqi

Vodhën me dhunë, pronari i shtëpisë: Jemi të frikësuar

Në pranga dy autorët, një tjetër në kërkim

Zbardhet për dy ditë gra bitja e ndodhur në një banesë në fshatin Greshicë të Mallakastrës, ku nën ushtrimin e dhunës me leva e mjete të forta ndaj anëtarëve të familjes, dy persona arritën të vidhin 2 milionë lekë të vjetra në një banesë. Policia e Fierit ka ndaluar të dielën 2 autorët e dyshuar të vjedhjes me dhunë dhe ka shpallur në kërkim bashkëpunëtorin tjetër. Të ndaluarit janë Klejdi Saliq dhe Arbër Muçaj, të dy banues në fshatin Panahor, të dy të dënuar më parë për vjedhje me armë në Greqi. Pronari i banesës, Përparim Merdani, tregoi për "News 24" momentet e tmerrit. Ai thotë se grabitësit ishin tre, ndërsa mbanin në duar shkopinj gome e thika. Ata e kanë goditur duke kërkuar me ngulm dhomën ku mbante paratë. Ndërsa ai nuk ua ka dhënë çelësin, grabitësit e kanë shqyer derën. "Dy çunat i kisha në sport, unë isha lart me nënën, mbesa shikonte telenovela. Në një moment na zë gjumi, ata atëherë erdhën. Dëgjova ulërimen e mbesës dhe u ngri-



Pronari i banesës, Përparim Merdani

ta. Ata erdhën me thika te koka na thanë "mos lëvizni!", - shprehet pronari i shtëpisë. **Ju kërcënuan?**

Mua më qëlluan, më goditën te hunda, më iku gjak, më është ënjtur edhe syri. Pasi kontrolluan, ishte

një dhomë me çelës, e shqyen derën e hynë te dhoma ku kishim lekët, 1 milion e 700 mijë lekë.

ARRESTIMI

Policia e Fierit ka ndaluar të dielën 2 autorët e dyshuar të vjedhjes me dhunë dhe ka shpallur në kërkim bashkëpunëtorin tjetër. Të ndaluarit janë Klejdi Saliq dhe Arbër Muçaj, të dy banues në fshatin Panahor, të dy të dënuar më parë për vjedhje me armë në Greqi. Pronari i banesës, Përparim Merdani, tregoi për "News 24" momentet e tmerrit.

I njohët?

Jo, ishin me maska, nga t'i njihja!

Sa persona ishin?

Tre veta, kishin shkop gome dhe thika në duar, m'i mbanin thikat në kokë.

I kanë dhunuar nënën dhe mbesën?

Jo, ato jo.

Jeni ndjerë të kërcënuar më parë?

Jo, jo asnjëherë. I linim dyert e shtëpisë të hapura. As kur filja nuk e mbyllja derën e shtëpisë.

E keni dëgjuar se janë arrestuar?

Nuk i njihja fare si persona.

Ju punoni zotëri?

Jo, pa punë jam.

Mund të kenë dëgjuar që keni para?

Po para ca ditësh erdhi vëllai nga Anglia dhe më la disa para për kurimin e nënës. Mund ta kenë dëgjuar.

Ndajeni të sigurt?

Po këtu s'ka as mbrojtje, asgjë. Jemi të frikësuar tani.

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE. LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA, ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ CELULAR SMARTPHONE OSE TABLET



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID


BalkanWeb.com
BW

FALAS



Britania e Madhe publikon emrat e 37 personave që janë në kërkim, mes tyre edhe 3 shqiptarë

Britania e Madhe ka publikuar listën e personave më të kërkuar nga policia, të cilët akuzohen për vjedhje dhe grabitje me dhunë. Kjo listë është shpërndarë edhe në rrjetet sociale për të bërë publikë emrat dhe për të lehtësuar gjetjen e tyre. Mes 37 personave në kërkim nga policia britanike janë dhe tre shqiptarë të identifikuar si Anton Krasniqi, Bledar Zefi dhe Marjo Marku. "Këta shkelës të ligjit kanë grabitur, vjedhur ose mashtruar udhëtarët dhe turistët brenda Londrës, shpesh duke përdorur dhunë dhe armë për fitimin e tyre financiar. Kush ka informacion për këta kriminelë, bëj thirrje që të na informojnë sa më shpejt që të jetë e mundur. Një telefonatë mund të zgjidhte ose edhe të parandalonte një krim", - ka thënë kryeprokurori Jim Corbett. Sipas mediave britanike, fytyrat e 37 të kërkuarve nga policia do të shfaqen publikisht në dy automjete, për të ndihmuar autoritetet në gjetjen e tyre dhe duke inkurajuar personat që kanë dijeni të japin informacion.



Dy shpërthime me tritol, policia i mban të fshehta

Dy shpërthime me tritol kanë tronditur Krujën dhe Shkodrën ditë e fundit, por policia i ka fshehur të dyja ngjarjet. Burime të "BalkanEeb" bëjnë me dije se shpërthimi i parë ka ndodhur mëngjesin e 21 marsit në fshatin Kukul të Shkodrës, në derën e rrethimit të banesës së shtetasit Marin Begeja. Nga shpërthimi ka pasur vetëm dëme materiale. Shpërthimi i dytë ka ndodhur mesditën e djeshme në fshatin Mallkuç të Krujës. Në mjetin tip "Benz", me targë AA 203 HU, në pronësi të shtetasit Flori Muça është vendosur lëndë plasëse. Për të dyja rastet, policia nuk ka shpërndarë asnjë komunikatë.

ISSH: Dokumentacioni i plotë që nevojitet, kush do të marrë të ardhura shtesë

Invalidët e rinj, cilat janë kushtet për të përfituar pension

Sa do të përlogaritet masa sipas grupit të invaliditetit

Voltiza Duro

Të gjithë ata persona që bëhen të paafte për çdo veprimtari ekonomike dhe kanë dëmtime fizike apo gjytime të forta, duke përfshirë verbimin, iu lind e drejta për pension invaliditeti. Sipas ligjit nr. 7703, "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; invaliditeti klasifikohet në tri grupe. Invaliditeti i pjesshëm është grupimi i parë, ku bëjnë pjesë të gjithë ata persona të siguruar që humbin aftësinë për punë në profesion, por janë ende në gjendje të kryejnë punë të tjera sipas përcaktimit të vendimit të KMCAP-it. Me tej grupi i dytë klasifikohet si invaliditeti i reduktuar në rastet kur personi i siguruar bëhet i paafte për çdo punë, ndërsa invaliditeti i plotë është grupimi i fundit i kësaj kategorie pensionesh nga i cili mund të përfitojnë të gjithë ata individë që ndodhen në kushtet e nevojës për kujdestari. Pension invaliditeti të plotë përfitojnë të gjithë ata persona që kanë plotësuar periudhën minimale të sigurimit, e cila është sa 3/4 e diferencës së moshës së personit të siguruar në kohën që bëhet i paafte dhe moshës 20 vjeç. Gjithashtu, duhet që individi në 5 vitet e fundit para lindjes së të drejtës të ketë së paku 12 muaj sigurim shoqëror si dhe të ketë humbur plotësisht aftësinë për punë, jo për shkak të aksidentit në punë apo sëmundjes profesionale.

KUSHTET DHE MASA

E drejta për të përfituar këtë lloj pensioni fillon pas mbarimit të periudhës 6-mujore të trajtimit me raport mjekësor për paafte-si të përkohshme në punë. Ndërkohë, në manualin e ISSH-së bëhet me dije se masa mujore e pensionit të plotë të invaliditetit përbëhet nga pensioni bazë dhe nga një shtesë pensioni që llogaritet si pensioni i pleqërisë. "Shuma bazë e pensionit iu jepet gjithë personave të siguruar. Ndërsa shtesa që iu jepet personave të punësuar, është 1% për vit sigurimi shumëzuar me bazën mesatare të vlerësueshme neto, që i siguruari ka arritur nëpërmjet kontributeve gjatë gjithë historisë së tij kontributive", - thekson ISSH. Gjithashtu, ISSH bën me dije se shuma e përgjithshme e pensionit nuk mund të jetë më e vogël se 75 për qind e pagës minimale neto në shkallë vendi. Sipas ligjit "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", në rastet kur përfituesi i një pensioni të plotë të invaliditetit bëhet i paafte dhe ka nevojë për një kujdes të vazhdueshme nga një per-



Foto Illustruese

INVALIDITETI I PJESSHËM

Në manualin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore theksohet se pensioni i invaliditetit të pjesshëm është sa 50 për qind e pensionit të plotë të invaliditetit dhe llogaritet në të njëjtën mënyrë si pensioni i plotë i invaliditetit.

3/4

DIFERENCA E MOSHËS

Pension invaliditeti të plotë përfitojnë të gjithë ata persona që kanë plotësuar periudhën minimale të sigurimit, e cila është sa 3/4 e diferencës së moshës së personit të siguruar në kohën që bëhet i paafte dhe moshës 20 vjeç.

son tjetër; atij i jepet një pagës shtesë prej 15% e bazës së vlerësueshme neto. Ndërsa, një person që merr pension invaliditeti të plotë dhe ka fëmijë në ngarkim deri në moshën 18 vjeç, ose deri në moshën 25 vjeç kur vazhdon studimet e larta me shqiptarë nga puna, do të marrë një të ardhur shtesë familjare për çdo fëmijë në masën 5% të pensionit bazë, por jo më shumë se 30% e tij.

PENSIONI I REDUKTUAR I INVALIDITETIT

Individët, të cilët kanë humbur plotësisht aftësinë për të punuar dhe që nuk kanë plotësuar periudhën

75%

SHUMA E PENSIONIT

Shuma e përgjithshme e pensionit nuk mund të jetë më e vogël se 75 për qind e pagës minimale neto në shkallë vendi. Në rastet kur përfituesi i një pensioni të plotë të invaliditetit bëhet i paafte dhe ka nevojë për një kujdes të vazhdueshëm nga një person tjetër, atij i jepet një pagës shtesë prej 15% të bazës së vlerësueshme neto.

minimale të sigurimit mund të përfitojnë pension të reduktuar invaliditeti. E drejta për të përfituar pension të reduktuar invaliditeti fillon pas mbarimit të periudhës 6-mujore të trajtimit me raport mjekësor për paafte-si të përkohshme në punë. Vlerësimi nga KMCAP duhet të bëhet në muajin e pestë ose të gjashtë, para përfundimit të kësaj periudhe. ISSH thekson se

masa mujore e pensionit të reduktuar të invaliditetit është e barabartë me masën e pensionit të reduktuar të invaliditetit të llogaritur sipas masës së pensionit të plotë të invaliditetit, shumëzuar me raportin e viteve të periudhave të sigurimit, që janë periudhat e sigurimit që i duhen për pension të reduktuar të invaliditetit. Gjithashtu, në rastet që ka nevojë për kujdestari si dhe në rastet kur ka fëmijë në ngarkim, pagesat llogariten po në njësoj si në pensionin e plotë të invaliditetit, me kushtet specifike përkatëse.

PENSIONI I PJESSHËM I INVALIDITETIT

Ashtu si në rastet e sipërpërmendura, personat që bëhen të paafte për të punuar përfitojnë në bazë të ligjit pension të pjesshëm invaliditeti. Kushtet për ta përfituar këtë pension janë po në njësoj me kriteret e renditura për 2 pensionet e tjera të invaliditetit. Ndërkohë, masa mujore e pensionit të pjesshëm të invaliditetit përbëhet nga pensioni bazë dhe nga një shtesë pensioni që llogaritet si pensioni i pleqërisë. Në manualin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore theksohet se pensioni i invaliditetit të pjesshëm është sa 50 për qind e pensionit të plotë të invaliditetit dhe llogaritet në të njëjtën mënyrë si pensioni i plotë i invaliditetit.

DOKUMENTACIONI:

a) Dokumentet që vërtetojnë moshën dhe identitetin:

- Fotokopje e letërnjoftimit elektronik, ose certifikatë lindjeje me fotografi.
- Certifikatë e gjendjes familjare.
- Certifikatë martesë (vetëm për aplikueset femra).

b) Dokumentet që vërtetojnë periudhat e sigurimit dhe llojin e punës:

- Librezë e punës.
- Vërtetim për vjetërsinë në punë dhe llojin e saj.

➤ Vërtetim për periudhën e sigurimit, i lëshuar nga zyra e arkivit pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore për punëdhënësit, të punësuarit, të vetëpunësuarit, të vetëpunësuarit në bujqësi dhe të siguruarit në mënyrë vullnetare, si dhe të siguruarit sipas VKM.

➤ Vendim gjykatë për njohje të vjetërsisë në punë (nëse shikohet e arsyeshme).

➤ Vërtetim i vjetërsisë në punë për ish-anëtarët e kooperativave bujqësore para vitit 1992.

➤ Vërtetim i Degës Ushtarake për periudhën e kryerjes së shërbimit të detyrueshëm ushtarak (për kërkuesit meshkuj).

➤ Vërtetim-tip i vjetërsisë në punë për ushtarakët.

➤ Fotokopje e noterizuar e diplomës së shkollës së lartë për kërkueset femra (kur kanë mbaruar studimet e larta, me shqiptarë nga puna).

➤ Çdo dokument tjetër justifikues, që vërteton qenien në punë.

➤ Vërtetim nga punëdhënësi për profesionin dhe natyrën e punës.

➤ Këto dokumente për efekt përfitimi pensioni invaliditeti do të pranohen kur personi nuk ka mbushur moshën e pensionit të pleqërisë.

c) Dokumentet që vërtetojnë të ardhurat e realizuara:

➤ Vërtetim page, sipas së cilës është derdhur kontribut për periudhat e sigurimit që nga 01.01.1994 deri në momentin e shqiptjes nga puna, sipas formularit-tip (nëse ka punuar dhe ka derdhur kontribute për periudhat pas datës 01.01.1994). Vërtetim i pagës mesatare neto, për vitin e fundit të punës.

➤ Çdo dokument tjetër justifikues, që vërteton pagën ose derdhjen e periudhave kontributive.

d) Dokumentet që vërtetojnë gjendjen shëndetësore:

➤ Fletë drejtimi për në KMCAP, lëshuar nga institucione shëndetësore me shtretër, (spital), shoqëruar me fletë-dalje nga spitali, ekzaminime e dokumente të tjera plotësuese, të kërkuara kur del për herë të parë në KMCAP.

➤ Fletë drejtimi nga KML për ato gjendje shëndetësore, që nuk janë objekt trajtimit në spital, sipas përcaktimit në rregullore.

➤ Epikrizë përcjellëse, lëshuar nga mjekë specialistë, apo konsulta e shoqëruar me ekzaminimet e nevojshme. Kur del për rikontrull duhet shoqëruar me ekzaminimet përkatëse zyrtare.

➤ Kartela personale dhe libri i shëndetit për të vërtetuar ecurinë e sëmundjes, ndjekjen dhe trajtimin mjekësor me ilaçe.

➤ Fletë drejtimi për KMCAP, që vërteton rëndimin e gjendjes shëndetësore, e vlefshme për KMCAP, para afatit të rikontrullit.

➤ Raport mjekësor lëshuar nga Komisioni Mjekësor, që përcakton gjendjen shëndetësore dhe aftësinë për punë (para fillimit të punësimit ose të përfshirjes në çdo skemë sigurimi).

➤ Raport mjekësor i lirim nga ushtria, lëshuar nga KMU pranë SQU, për ushtarët që bëhen invalidë gjatë shërbimit ushtarak.

➤ Vërtetim për pagesën e paafte-sisë për punë, shkaktuar nga një sëmundje e përgjithshme (për punëmarrësin).

HRUSHOVI NDIKIMI NE TIRANE

Historia e panjohur e vizitës së Nikita Hrushovit në Shqipëri, në vitin 1959

Hrushovi: Enver Hoxha është një bandit, u vinte litarin në qafë njerëzve dhe e tërhiqte

Akuzat e Hrushovit: Të gjithë ata që i dalin kundër Enveri i quan revizionistë, kjo është tragjedi për popullin shqiptar

Spartak Topollaj

(vijon nga numri i kaluar)

Në kontekstin e kohës dhe klimës ndërkombëtare të një bote të ndarë në dy kampe, kjo vizitë e Nikita Hrushovit merret një rëndësi shumë të madhe për Shqipërinë e vogël komuniste, rëndësi që propaganda zhdanoviane e të dyja vendeve (sidomos ajo shqiptare), do ta trumbetonte me të madhe. Vizita e shumëpritur, madje e mezipritur e "mikut më të madh", me stërzgajtjen e habitshme e të paparashikuar nga askush, çuditi botën. Ajo u realizua nga 25 maji deri më 4 qershor 1959, pra zgjati plot 11 ditë, gjatë të cilave Hrushovi i ra kryq e tërthor Shqipërisë, nga Shkodra në Sarandë. Në këtë vizitë jo pa domethënie, ai kish marrë me vete marshallin Rodion Malinovski, ministrin e Mbrojtjes që zëvendësoi Zhukovin. Interesant është fakti që tri javë para se të vinte në Shqipëri, Hrushovi i kish dhënë një intervistë të gjatë gazetës së njohur greke "TO VIMA" në të cilën, pasi fliste për lidhje të hershme (fejja ortodokse), kërkonte miqësi mes dy vendeve. Por, Bashkimi Sovjetik nuk mund të pranonte bazat e huaja ushtarake (NATO-SHBA), apo instalime raketash deri dhe ato me mbushje bërthamore, që mund të shkaktonin reaksion për një goditje atomike me pasojë tragjike për të gjithë rajonin gjigëthëgadhishullor. Në mitingun e Shkodrës, ai kanosi edhe Italinë fqinje, tjetër fuqi e madhe NATO-s kjo, që sipas tij e padyshim edhe Enverit, kërcëronte Shqipërinë Socialiste, madje shkoi edhe më tej në mitingun e madh të Tiranës, ku nga ballkoni i Bashkisë deklaroi se për mbrojtjen e Shqipërisë, Traktati i Varshavës dhe Bashkimi Sovjetik, edhe pa sjellë armët konvencionale, vështirësisht të kalueshme në territorit vendeve të tjera, mund të godiste direkt nga territori sovjetik!

DEKLARATAT KONTRADIKTORE TË HRUSHOVI NË SHQIPËRI

Kontradiktor e shpesh konfuz në deklaratat dhe pikëpamjet e tij, siç që rasti edhe për minoritetin grek në Shqipëri, Hrushovi nuk



Enver Hoxha dhe Nikita Hrushov gjatë vizitës në Shqipëri

është se gjeti mbështetje të plotë nga dyshja Hoxha-Shehu, e po ashtu edhe nga krerët grekë të politikës e shtetit, si Venizellos, Karamanlis, Papandreu, Averof etj. U quajt hipokrizi dhe e papranueshme teza hrushoviane e çarmatimit në Ballkan, aq më tepër kur rreziku i një sulmi nga vende komuniste me Bashkimin Sovjetik në krye ndaj Greqisë nuk përjashtonte. Shantazhi i Hrushovit, sidomos ndaj Greqisë dhe Italisë, nuk ishte rastësi që u bë nga Shkodra, Korça, Butrinti dhe Vlora, ku në këtë të fundit ishte dhe baza e madhe strategjike ushtarako-detare e Pasha Limanit me 12 nëndetëse, ndërkohë që Italia kishte 2 dhe Greqia vetëm 1 të tillë! Po ashtu, nuk ishte harruar nga grekët dhe anglo-amerikanët ndikimi i Shqipërisë dhe roli i saj gjatë Luftës Civile në Greqi, të cilat Enver Hoxha më vonë i ka paraqitur krejt ndryshe nga e vërteta në librin e tij "Dy popuj miq", sidomos kur shkruan se çfarë përfaqësonin ELAS-i, EAM-i, EDES-i etj., dhe komandantët e tyre si Veluciotis, Vaviadhis, Zahariadhis, Zervas, Grivas dhe Papaagos. Ndihmat e UNRRA-s dhe Plani Marshall i Presidentit Truman iu paraqitën Hrushovit nga Hoxha, ashtu si ia desh momenti dhe konjuktura. Edhe për minoritetin grek në Shqipëri, Hrushovi ishte konfuz, teksa tentoi të bëjë kompetentin në fushat e historisë, gjithësisht dhe etnogjenezës së popujve, fusha në të cilat ai për hir të së vërtetës linte shumë për të dëshiruar. Nga ana tjetër, Enver "parimori" pranoi të mos e sulmon-

te, madje as ta përmendte Titon, në "respekt" të kërkesës së mikut Hrushov, për sa kohë zgjati edhe vizita e tij në Shqipëri, duke vërtetuar se vetë intransigjenca e tij me Titon, që me aq zell propagandonte Hoxha, s'ishte gjë tjetër veçse një falsitet. Nikita Sergejeviçi do të mbahet mend nga shqiptarët edhe për propozimin e tij për të ngritur plantacione agrumesh, pasi për sa drithë kishte nevojë Shqipëria, në Bashkimin Sovjetik e hanin minjtë nëpër depo! Gjatë kësaj vizite në qendër të Tiranës, atje ku që nga thellësia e shkejve ishte Pazarri i Vjetër (prishja e të cilit ishte një nga absurdet e kohës), Hrushovi vendosi gurin e parë për ndërtimin e Pallatit të Madh të Kulturës, një vepër kjo ende mjaft e diskutueshme nga çdo pikëpamje.

ËNDRRA E VJETËR E CARËVE SHOVENË RUSË PËR SHQIPËRI

Ëndrra e vjetër e carëve shovenë rusë ishte dalja në Mesdhe, apo ngritja e bazave të mëdha ushtarake sidomos në Adriatik dhe Jon, prej nga ku Otranto (pra vetë Perëndimi), ishin jo më shumë se 75 km distancë! Të kushëtuar nga darshtërguese e Bosforit dhe Dardaneleve të një ish-perandorie, si ajo turke aktualisht, edhe ajo fuqi e madhe e NATO-s, sovjetikët dhe më konkretisht Hrushovi e Malinovski nuk e fshihnin aspak dëshirën që ta përdornin Shqipërinë si një plasdarmë dhe avancpost. Një Zot e di se çfarë mendonte në të vërtetë Enver Hoxha në ato ditë kur delegacioni më i lartë sovjetik vizitonte Shqipërinë, por një

gjë dihet mirë, që ai ishte në apogjeun e delirit të tij të protagonizmit dhe madhësisë. Për më tepër, mjeshtri i madh i hipokrizisë dhe kameleonizmit, që u shqua gjatë gjithë jetës për lojën e dyfishtë, pikërisht në ditët e vizitës së delegacionit të lartë sovjetik, saktësisht më 27 maj, kish ftuar për vizitë edhe ministrin e Mbrojtjes së Kinës Popullore dhe anëtarin e fuqishëm të Komitetit të Përhershëm të Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës, Marshallin e njohur Peng Dehuai (1898-1974), i cili ndoshta thjesht për koïnçidencë, u shkarkua nga Mao Ce Duni, si edhe homologu i tij sovjetik Zhukov, fill pas vizitës në Shqipëri, madje i shkreti Peng Dehuai pati një fund shumë më tragjik se Zhukovi, se pas kundërshtive të forta me Maon dhe Lin Biao, rivalin e përjetshëm që i zuri vendin, u shkarkua në Konferencën e Lushan e më pas u poshtërua publikisht gjatë Revolucionit Kulturor Proletar, u arrestua dhe u torturua deri sa vdiq, Hrushovi dhe Malinovski, ndërkohë s'kish si të mos e kuptonin domethënien e vizitës së Pengut në Shqipëri, në të njëjtën kohë me ata. Sido që të ishte, Hrushovi e mbylli me sukses të përkohshëm vizitën në vendin tonë më 4 qershor 1959, ai i shoqëruar ashtu si edhe kur erdhi nga tete



puthjeve homoseksuale buzë më buzë, nga e gjithë udhëheqja më e lartë e Partisë e Shtetit, me vetë Stalinin shqiptar, Enver Hoxhën në krye!

HRUSHOVI NGA SHQIPËRIA, VIZITË NË SHBA

Thuhet se Hrushovi në TU-104 e tij mori me vete, veç konstruktorëve të famshëm të avionëve "Andrej", edhe Aleksej Tupoljev, babë e bir, edhe konstruktorët e tjerë, jo më pak të famshëm se ata, Jakovlev, Iljushin, Mikojan, Gurjeviç, Sukhoi dhe Antonov. Madje, në ditët e vizitës së gjatë të tyre, po në Rinas u ul për provë edhe gjiganti sovjetik ajrit, krenaria e AEROFLOT-it për kohën, TU-114, me të cilin Nikita Sergejeviç Hrushovi plot katër muaj më vonë do të futuronte drejt SHBA-ve, ku i ftuar nga presidenti i shquar amerikan, Gjenerali fitues i Luftës së Dytë Botërore, Duajt Ajzenhauer, do të ulej në bazën ajrore Andrews, pranë Uashingtonit, në të parën vizitë të një lideri sovjetik në tokën amerikane. I befusuar dhe i trondi-



udhëheqës të lartë të Partisë dhe shtetit sovjetik. U përçoll me po atë madhësi e përzemërsi që edhe u prit në aeroportin e ri, atë të Rinasi, ndërtuar me stërmundimin sfitës dhe gjakun e të burgosurve politikë të regjimit, deri dhe me stilin sllavo-ortodoks të tri herë

tur nga kjo vizitë e shokut Hrushov, Enver Hoxha urdhëroi kalimin gati në heshtje të saj nga propaganda zhurmëmadhe e jona dhe pompimin e forcimit të marrëdhënieve e miqësisë me Kinën e kuqe të Maos në Lindjen e Largët, duke shfrytëzuar 10-vjetorin e ➔



← Shpalljes së Republikës Popullore të Kinës. Nga ana tjetër, teksa pa, dëgjoji dhe ndjeu në ç'nivël ishte Amerika në të gjitha fushat, Hrushoviu iu "prenë gjuhët", duke e lënë në mes garën paqësore me SHBA-te.

KRISJA E MARRËDHËNIEVE MES TIRANËS E MOSKËS, PAS VIZITËS SË HRUSHOVIT

Tani në marrëdhëniet shqiptaro-sovjetike fillon acari. Për paradoks, ai ndryshe nga sa nudohej me motin në atmosferë, i cili nis e ftohet në vjeshtë nga erërat që fryjnë nga verilindja drejt jugperëndimit, ndodhi e kundërta. Dy ishin momentet kulmore, Konferenca e Bukureshtit, qershor 1960, ku Hoxha dërgoi Hysni Kapon dhe PPSH iu bashkëngjiti tezave kineze të Maos dhe PKK, dhe Mbledhja e Moskës e 81 Partive Komuniste e nëntorit 1960-të, pas së cilës askush s'kishte më dyshim për shizhëm të madhe të Lëvizjes Komuniste Botërore, ku Enver Hoxha mbajti fjalimin dhe qëndrimin e njohur jo vetëm nga dokumentet e publikuara herët, apo ato të deklafikuara së fundmi, por edhe nga kryevepra artistike e gjenit tonë të përmasave botërore, fituesit të çmimeve më të mëdha letrare ndërkombëtare nobelistit de fakto, Ismail Kadare, "Dimri i vetmisë së madhe", pa harruar edhe kujtimet autentike të dy protagonistëve të panënvlerësueshëm, Frederik Gjerazi dhe Myfit Mushi, përkthyesit zyrtarë të delegacionit shqiptar. Sovjetikët bëjnë të gjitha përpjekjet që marrëdhëniet të mos shkojnë deri në prishjen përfundimtare, ndërsa nga PPSH-ja vetëm një grua, ndoshta më e zonja në të tërë udhëheqjen sklerotike dhe mediokre shqiptare, Liri Belishova, pas një vizite në Kinën e largët, në kthim e sipër ndalon në Moskë, ku bisedon me sovjetikët, por Enver Hoxha nuk dëgjon nga ai vesh, madje më keq akoma, e akuzon për rënie në pozitat e revizionistëve hrushovianë dhe për të e gjithë familjen e saj fillon kalvari i vuajtjeve dhe poshtërimeve pa fund, që kulmuar me arrestimin dhe bur-

gosjen në burgun llahtar të Burrelit, (ku edhe kish vdekur Koço Kota, ministër Drejtësie i Zogut, që edhe e kish ndërtuar atë) e bashkëshortit të dytë të saj, Maqo Çomos, anëtar i Komitetit Qendror dhe ministër i Bujqësisë (bashkëshortin e parë të Belishovës, anëtar i Byrosë Politike, ministër Ekonomie dhe kryetar i Komisionit të Planit të Shtetit, ndër kuadrot më të shquara të Rinisë e Partisë, Nako Spirun, pasi e akuzuan si anti-jugosllav, e vetëvranë me dy plumbat)! Vetë Lirinë e internuan në Memaliaj e Cërrik, ku iu sëmur rëndë dhe më pas, e shtruan në Spitalin Onkologjik të Tiranës, edhe i vdes vajza e vetme, e mençura dhe e bukura poete Drita Çomo, të cilën edhe në agoni nuk ia lejuan ta shohë, paçka se në një përpjekje të fundit dëshpëruese, iu drejtua duke iu lutur si nënë, si grua, si bash-



këluftëtare, Nexhmije Hoxhës, por nepërka, apo pantera e zezë, siç e ka përcaktuar shumica e shqiptarëve, e refuzoi çnjerëzish! Bashkë me Belishovën u ndëshkua rëndë edhe Koço Tashko, ndër komunistët më të vjetër, nga një familje atdhetarësh, të cilit shqiptarët do t'ia dinë për "nder" që një ditë nëntori të 1941-it, teksa e takon krijtarëstësish, kthen nga rruga Enver Hoxhën, njohje e vjetër që në Ko-



rcë, për ta ftuar të marrë pjesë në Mbledhjen e Grupeve Komuniste të thirrur e kryesuar nga dy shokët e "deleguar" jugosllavë, Popoviqi dhe Mugosha për të themeluar PKSH në Tiranë!

Pasojat e prishjes së marrëdhënies me Bashkimin Sovjetik Muajt që pasuan ishin plot ngjarje, nga të cilat do të përmendim Kongresin e IV të PPSH-së (shkurt 1961), ku sovjetikët dërguan Pospjellovin e njohur, që dështoi në misionin e tij edhe pse Enveri nuk e përmendi Hrushovin, apo Partinë Komuniste të Bashkimin Sovjetik. Përballimin e madh e kemi në bazën e Pasha Limanit, ku sovjetikët këmbëngulnin të merrnin të gjitha nëndetëset dhe pjesën më të madhe të Flotës Luftarake Detare, por s'ia dolën dot as me forcë e as me provokacione. Në fund pala shqiptare arriti të mbante katër anije nënujëse dhe sovjetikët tetë të tilla. Sovjetikët përzunë studentët dhe specialistët tanë nga Bashkimi Sovjetik dhe tërhoqën këshilltarët dhe specialistët e tyre civilë e ushtarakë nga Shqipëria (pa pyetur ata, kurrë nuk merreshin vendime). Në nëntor 1961, pas një fjalimi shumë të ashpër të Enver Hoxhës kundër revizionistëve hrushovianë, u mbërrit deri tek akti i fundit: marrëdhëniet diplomatike mes dy vendeve u prenë, për t'u rivendosur vetëm pas plot 30 viteve, më 1991, por asnjëherë në nivelin e dikurshëm, e kjo në shumë vite për faj të autokratit Putin, ish-

cakton në kujtimet e tij Hrushovi diktatorin shqiptar: "Enver Hoxha është thjesht një bandit! Vallë, politikan është ai, që njeh vetëm një metodë, litarin në fyt dhe tërhoq fort! Të gjithë ata që ngrihen kundër vrasjeve të fshehta dhe të hapura e që ngrënë zërin për demokratizimin e jetës së Partisë dhe të vendit qenkan revizionistë?! Natyrisht që kjo, në radhë të parë është tragjedi për popullin Shqiptar... Tamam kështu ka ndodhur edhe me në kohën e Stalinit, i cili ideoi dhe organizoi pushtatimin e mijëra kuadrove drejtuese të ndershme, ndërkohe që të gjithë thërrisnin: Rroftë Stalini! Nga ana tjetër, titullin "miku më i madh", Enveri ia akordoi Maos, përsa kohë, Kina e tij e ndihmoi fuqimisht në çdo fushë Shqipërië. Më pas, historia përsëritet si me Titon dhe Hrushovin. Enveri s'kapërdiu kurrë pritjen e Niksonit në Kinë e pas tij edhe të Josip Broz Titos. Vdekja e Maos, para tij dhe e Liu Shao Çi, Çu En Lai, e Çu Deh u vuiri kapak raporteve vëllazërore. Tani "floriri i vogël" Teng Hsiao Ping udhëheq me vizion Kinën drejt aritjeve të jashtëzakonshme.

HRUSHOVI, NJË PERSONALITET KOMPLEKS APOKALIPTIK

Nikita Sergejeviç Hrushovi do të mbetet në histori një personalitet kompleks e apokaliptik. Ai ishte prurësor i një politike, që i dha goditjen më të rëndë Stalinit, apo më saktë stalinizmit despotik autarkist, kultit të tij të individit. Por Hrushovi nuk e pati të lehtë ta bënte këtë. Ai u përball me një aparat gjigant partiako-shtetëror, e ushtarako-policor, të mësuar me dhunë represive, çka nuk ndalej dot menjëherë e me një dekrete të vetëm. Nën presionin e këtyre konservatorëve, ai bëri edhe tërhoqe, duke pranuar se Stalini kishte edhe vlera e merita (paçka se trupin e balsamoi ia nxorën nga Mauzoleu dhe ia dogjën, hirin e mbetur e vendosën në Murin e Kremlinit, krahas atyre të udhëheqësve të vdekur), sidomos në fitoren e madhe të Luftës së Dytë Botërore. Edhe pse miliona të burgosur dhe të internuar në Gulagët e tmerrshëm siberianë u liruën e u rehabilituan, si edhe shumica e udhëheqësve të ekzekutuar pa drejtësisht morën pas vdekjes nderimin e merituar, s'duhet harruar se Pasternaku s'iu lejua të marrë Çmimin Nobel, Saharoi e Söllzhjenjicini ende ishin 'dele të zezë', futbollisti më i madh Strelcov i burgosur për kapriçiot e ministres Furceva, më saktë, pasionit të njëanshëm të së bijës për të e më pas i rehabilituar, apo dhe shkëmbimi i pilotit amerikan të avionit U-2, Francis Gary Powers me super-

spiunin sovjetik Rudolf Abel nuk mund të jetë më përmendim.

Si e vlerëson historia Nikita Hrushoviu?

Më në fund, nën presionin e krahu ende të fuqishëm konservator stalinist brenda Partisë dhe shtetit sovjetik, Hrushoviu shkarkohet nga të gjitha funksionet e tij partiako-shtetërore më 14 tetor 1964 dhe zëvendësohet prej Leonid Brezhnjev, një version i autokratit gjysmëstalinist, që sundoi deri më 1982-in. Hrushoviu i jepet një pension modest dhe një daça në periferi të Moskës, ku e kalon kohën në gjah dhe i ndihmuar nga i biri Sergei dhe dhëndri Aleksej Axhubej, i famshmi kryeredaktor i "PRAVDA"-s, shkruan kujtimet, që i boton që në gjallje të tij, më 1970, një vit para se të ndërronte jetë më 11 shtator 1971. Dhe ja ç'thotë vetë ai për jetën e veprën e tij: "Kur të vdes... njerëzit do të venë në kandar veprat e mia. Në njërin anë të këqijit, në tjetrën - të mirat dhe këto të fundit... do të rëndojnë më tepër". Por ç'kanë thënë e shkruar të tjerët për të? Si për të gjithë personalitetet e këtij formati, mendimet dhe vlerësimet e tyre janë pa fund, nga më të ndryshmet e shpesh kontraverse. Në këtë kuadër u shkruan edhe këto opinione e fakte, si një kontribut modest, vlerësimin e të cilëve, le t'ia lëmë lexuesit ta bëjë... Duke iu rikthyer atyre çka shkruan më hyrje të këtij artikulli me opinione e fakte, le të shkruajmë edhe disa rreshta për vizitat e personalitetëve të huaja, që në vite vizituan Shqipërië, si një plotësim që gjuajmë se do të ishte mirë të mos mungonte.

PERSONALITETET E TJERA QË VIZITUAN SHQIPËRIË

Kështu, personaliteti më i madh që e vizitoi Shqipërië në gjallje të Hoxhës, madje dy herë, ishte kryeministri më i madh kinez i të gjithë kohërave, Çu En Lai me ministrin e Jashtëm, Marshallin Çen Ji dhe Li Hsien Nien, që u bë Presidenti i Kinës e delegacione të tjera të larta partiako-shtetërore dhe ushtarake kineze. Përandorë si Haile Selasie I i Etiopisë, presidentë si Këame Nkrumah i Ghanës, mbretëri si Norodom Sihanuk i Kamboxhias, sekretari i Përgjithshëm i OKB-së Perez de Kuejar etj. Me shembjen e regjimit totalitar dhe vendosjen e demokracisë, presidenti Breshiva vizitoi dy herë Shqipërië e Bardhë (i vetmi deri me tani) në Zyrën Ovale të Bushit senior dhe Klintonit. Në prill të 1993-shit, për herë të parë në historinë e Papatit, Papa Gjon Pali II viziton një vend të Ballkanit, dhe ky vend, i vetmi në botë që kish mbyllur institucionet fetare, ndaloj fenë dhe ekzekutoi dhjetëra klerikë nën diktaturë, ishte Shqipëria, tashmë demokratike. Atë e kishte vizituar sekretari Bejker, pritur me madhësi (qershor 1991), sekretarët Pauell, Ollbrajt, Kerry, H. Klinton, presidentët Bush senior e Karter, presidentët gjermanë Vaiczeker e Hergog, kancelarja Merkel, Gensheri i Kinkeli, Andreoti e Berluskoni, Prodi e Bleri, Papa Françesku etj., por kryevizita historike, e para dhe e vetmja deri më sot e një presidenti në detyrë, e të vetmes superfuqi botërore do të mbetet ajo e Presidentit të SHBAve, Xhorxh W. Bush, pritur si askush më parë, në qershor 2007, me ftesë të kryeministrit Berisha, ku u deklarua se Shqipëria do të hynte në NATO dhe se Kosova do të shpallej e pavarur!

(Diplomat dhe studiues i marrëdhënies ndërkombëtare)

UISSH: Kush do të testohet në profilin teknik laborator e teknik imazherie

Voltiza Duro

Lista me 988 kandidatët që do t'i nënshtrohen provimit në profilet e mjekësisë Test mbi aftësitë profesionale në fizioterapi, mami e logopedi

Përgjatë muajit prill praktikantët e degëve të shëndetësisë do t'i nënshtrohen provimit të aftësimi praktik VAP...

me dije se në ditën e provimit duhet të kenë vetë kartën e identitetit, një përparëse të bardhë dhe kartën e praktikantit...

dhrorit të Infermierit. Gjatë vitit 2012, Urdhri i Infermierit ndryshoi kushtet për të gjithë kandidatët që dëshironin të hyjnë në provimin e shtetit.

sional në fund të saj, ndërkohë që vetëm nëse vlerësohen pozitivisht në të, kanë të drejtë të regjistrohen për provimin e shtetit.

e praktikës profesionale. Në këtë librezë mbahen shënimet ditore përgjatë 12 javëve që studenti realizon praktikën, të cilat firmosen çdo ditë nga drejtuesi i saj.

sisht, ato janë nga 10 deri në 25 pikë, të cilat i njihen kandidatit gjatë realizimit të testimit profesional.

EMRAT ME KANDIDATËT QË DO T'I NËNSHTROHEN PROVIMIT TË SHËTITIT NË PROFILET E MJKËSISË

Table with columns: Nr., Emri, Mbiemri, Kodi and lists of names for various professions like Laboratory Technician, Imaging Technician, Physiotherapist, etc.

MJEKU POPULLOR



Ylli Merja:
Si të trajtoni
osteoporozën me
bimë mjekësore


KESHILLA



Problemet
me dëgjimin,
si mund t'i
parandaloni

Veronika Duci:

Prof. asoc.,
psikologe/
psikoterapiste:
Si duhet
të veproni
për të
fituar
besimin



Kur është momenti i duhur për të nisur psikoterapinë

"Kujdes, mos kini frikë nga
paragjykimet e njerëzve!"

• Ja cilat janë 6 ushqimet më të mira për trurin. Efektet e mrekullueshme të vajit të peshkut në organizëm

Prof. asoc., psikologe/psikoterapiste: Si duhet të veproni për të fituar besimin

Veronika Duci:

Kur është momenti i duhur për të nisur psikoterapinë

"Kujdes, mos kini frikë nga paragjykimet e njerëzve!"

Voltiza Duro

Të gjithë ne përballemi me situata të vështira e në shumicën e rasteve përpiqemi të zgjidhim vetë çdo problem apo të këshillohemi me miqtë e të afërmit. Konsultat me psikologun vazhdojnë ende të ngelen një tabu për shumë shqiptarë, të cilët mbi të gjitha kanë frikë nga paragjykimet, nëse u drejtohen seancave të psikoterapisë. Në një intervistë për suplementin "Life Pages" në "Gazeta Shqiptare", prof. asoc. Veronika Duci, psikologe/psikoterapiste tregon se kur është momenti i duhur për një person për të nisur seancat e psikoterapisë. Ajo thekson se vetë procesi terapeutik do ta drejtojë individin dhe psikoterapistin në zbulimin e gjërave të reja. Duci e konsideron psikoterapinë si një dhuratë që kushdo ia bën vetes dhe shton se frika nga paragjykimet e njerëzve duhet të eliminohet, duke mos u shqetësuar se çfarë mendojnë të tjerët.

Në shumë raste ndodh kur pacientëve u këshillohet nga personat përreth psikoterapia. Si reagojnë pacientët në këtë moment?

E vërteta është se shpesh mund të jemi në "mohim" kur përballemi me situata të vështira dhe përpiqemi të gjejmë vetë zgjidhjen e të gjitha problemeve. Pasojë e kësaj është stërmundimi i vetes, mbush-

ja me mendime negative dhe ndjenja e lodhjes mendore, emocionale dhe fizike. Por, nëse shumë njerëz ju thonë të njëjtën gjë, mos janë duke parë diçka tek ju që vetë nuk e pranonin?

A ka një moment të duhur për të filluar psikoterapi?

Zakonisht, ne presim një shkas që të fillojmë psikoterapi: një divorc, një vdekje, një ndarje. Për gjithsecilin, momenti i fillimit të terapisë është i veçantë dhe unik. Nuk ka një moment të duhur për të filluar psikoterapi, sepse kur mendoni me "duhet" nuk do ta lejonin veten që të ndihmohet nga procesi terapeutik.

A duhet të kenë individët një shqetësim të madh për t'iu drejtuar psikoterapisë?

Shumë njerëz presin një shkas për të filluar terapi. E vërteta është

të se askush nuk ka nevojë për një shkas. Vetë procesi terapeutik do ju drejtojë juve dhe psikoterapistin tuaj në zbulimin e gjërave të reja për veten.

Keni pasur raste kur personat kanë menduar që psikoterapia mund të zëvendësohet me biseda me miqtë më të mirë?

Psikologu/psikoterapisti nuk është dhe nuk do të jetë shoku/shoqja juaj. Është një profesionist, me të cilin do të zhvilloni një "aleancë terapeutike". Është ai/ajo që objektivist do ju ndihmojë që të përmirësoni mënyrën tuaj të funksionimit dhe të synoni vetëpërmirësimin tuaj.

A kanë frikë individët të nisnin seancat me psikoterapistin? Pse vjen kjo frikë?

Psikoterapia nuk është diçka për t'u frikësuar. Ajo çfarë i frikë-



Prof. asoc., psikologe/psikoterapiste, Veronika Duci

son zakonisht njerëzit është vetja e tyre dhe fakti se ata mendojnë se do ndryshojnë. A ka dhuratë më të madhe sesa mospërsëritja e gabimeve të së kaluarës?

Sa shpesh duhet të realizohet takimi me psikoterapistin/en?

Kjo është një çështje për t'u diskutuar me terapistin/en tuaj. Në sesionin e parë ai/ajo do t'ju kërkojë që të përcaktoni së bashku qëllimin e terapisë dhe të projektoni rrugëtimin drejt këtij qëllimi.

Ka raste kur personat kanë shkuar më përpara në një psikolog, por tani e ndjejnë se kanë nevojë

të rifillojnë terapinë. A është e logjishme që të krahasohet psikologu i vjetër me të riun?

Nuk ka arsye për t'u ndjerë në faj për këtë. Nëse keni vendosur që të ndryshoni terapistin tuaj, duhet kohë për t'u mësuar dhe për të gjetur mënyrën e komunikimit me terapistin e ri. Është e logjishme që në fillim të ndjeni paretë, të krahasoni dhe të ndjeni se nuk doni t'ia nisni nga fillimi. Është një formë mbrojtjeje dhe rezistence.

A ekziston frika e paragjykitimit nga njerëzit e afërt apo komuniteti përreth në momentin që një individ vendos të shkojë te psikologu?

Nëse ndjeni se keni nevojë për ndihmë, nuk duhet t'ju shqetësojnë mendimet e të tjerëve. Psikoterapia është një dhuratë që ia bëni vetes.

Çfarë karakteristikash duhet të ketë psikologu/a që të ofrojë besueshmërinë e nevojshme të pacientit?

Për secilin prej nesh karakteristikat e terapistit/es së vet janë unike. Çfarë duhet të keni në mendje është krijimi i "aleancës terapeutike" dhe ndjesia se mund të keni besim tek ai/ajo dhe se mund t'ju ndihmojë. Terapisti juaj është një profesionist që i nënshtrohet një kodi etik, për këtë arsye është dikush i besueshëm që do t'ju shoqërojë në rrugëtimin tuaj psikoterapeutik.



Voltiza Duro

Zona e kockës ku sasia e mineraleve pakësohet shumë dhe densiteti ulët shkakton sëmundjen e osteoporozës. Kjo është sëmundja më e shpeshtë e kockave, që dallohet në moshat mbi 40 vjeç, sidomos te femrat që kalojnë menopauzën. Emri i saj vjen nga latinishtja dhe përshatet me termin "kockat poroze". Brenda një kocke të shëndetshme ka hapësira të vogla, si një hoje mjalti dhe kjo është mëse normale. Njeriu ka kocka shumë të dendura që nuk kanë hapësira, por ka edhe kocka ku këto hapësira poroze janë të pranishme. Osteoporozja rrit madhësinë e këtyre hapësirave, duke bërë që kocka të humbasë forcën dhe densitetin e saj.

Simptomat e osteoporozës
Në shumicën e rasteve, njerëzit me osteoporozë nuk e dinë se e kanë këtë sëmundje derisa të kenë një thyerje. Pa trajtim të përshtatshëm, osteoporozja mund të përkeqësohet. Ndërsa kockat bëhen më të holla dhe më të dobëta, rreziku i thyerjes rritet. Simptomat e osteoporozës së rëndë mund të përfshijnë një thyerje nga një rënie apo edhe nga një teshitimë e fortë ose kollë. Ato gjithashtu mund të përfshijnë dhimbjen e shpinës ose të qafës, ose humbjen e gjatësisë. Këto dy simptoma të fundit mund të shkaktohen nga një frakturë kompresioni (shtypje). Kjo është një thyerje në një nga rruazat në qafë ose shpinë, e cila dobëson strukturat anatomike saqë prishet presioni normal në shpinë.

Shkaqet

Shkaku kryesor i osteoporozës është moshja. Pas moshës 35 vjeç fillon të dobësohet puna në drejtim të prodhimit të qelizave të kockës për nga fortësia si më parë. Një tjetër shkak kryesor i osteoporozës është menopauza, e cila ndodh te gratë rreth moshës 45-55 vjeçe. Për shkak të ndryshimit në nivelet e hormoneve që lidhen me të, menopauza mund të ndikojë që trupi i një gruaje të humbasë densitetin kockor edhe më shpejt. Burrat vazhdojnë të humbasin densitetin kockor në këtë moshë, por me një ritëm më të ngadaltë se gratë. Sidoqoftë, në kohën kur arrijnë moshën 65-70 vjeç, gratë dhe burrat zakonisht humbin densitetin kockor në të njëjtën shkallë. Shkaqe të tjera të osteoporozës përfshijnë disa kushte mjekësore të tilla si hipertiroidizmi. Ato gjithashtu përfshijnë përdorimin e barnave të caktuara farmaceutike.

Parandalimi

Nuk ka shërim për osteoporozën, por trajtimi i duhur mund të ndihmojë në mbrojtjen dhe forcimin e kockave. Ka shumë faktorë të rrezikut për osteoporozën që nuk mund t'i kontrollohen. Këto përfshijnë të qenit femra, moshja dhe një histori familjare me osteoporozë. Megjithatë, ka disa faktorë që bien brenda kontrollit tuaj. Disa nga mënyrat më të mira për të parandaluar osteoporozën përfshijnë: marrjen e



Mjeku popullor: Ja cilat janë simptomat dhe shkaktarët kryesorë të sëmundjes

YLLI MERJA: Si të trajtoni osteoporozën me bimë mjekësore

"Masazhoni trupin me vajin e sinapit, efekt i menjëhershëm"



Mjeku popullor
Ylli Merja

kalciomit dhe vitaminës D, një dietë e ekuilibruar me vitamina, minerale, fibra të shëndetshme. Rekomandohet të mos mbani dieta për ulje në peshë për një kohë të gjatë, pasi ato çojnë në hollimin e kockës, të mos konsumoni shumë kripë, të kufizoni përdorimin e kafes në 1 herë në ditë.

Kurimi me bimë mjekësore

Fillimisht duhet të bëni lyeje nga gishtat e këmbës drejt legenit, nga legeni drejt shpinës dhe nga gishtat e dorës drejt supit 2 herë në ditë me ekstraktin e variceve, që nxit qarkullimin e gjakut. Pasi thahet, vendoset vaji i sinapit që është një qetë-

sues, zbutës dhe rigjenerues dhe forcues i strukturave të dëmtuara. Në rastet kur ka dobësim të tendinave, duhet të bëjmë masazh të lehtë me ujë të ngrohtë e sapun. I mrekullueshëm është vaji i sinapit. Kur qarkullimi i gjakut veshirësohet, menisqet mund të spostohen e të shkaktojnë dhimbje, por me ekstraktin e variceve dhe vajin e sinapit mund ta masazhoni zonën e kështu dhimbja do të përmirësohet. Në 3 litra ujë të valuar shtojmë një pako çaj reumatizme, 1 dorë këputje, 1 dorë hithra, një dorë tërfili, një dorë lule murri. Ziejnë bashkë për 3 minuta dhe i lini në qetësi 15 minuta dhe i kulloni. Pini 3 gota në ditë para ushqimit. Bimët që ndodhen

në këtë çaj përmbajnë shumë minerale, që ndihmojnë në shëndosjen e kockës.

Metoda e guaskës së vezës:

Marrim 3-4 guaska vezësh, i thërrmtojmë, i hedhim në një kavanoz të mbushur me 300 ml lëng limoni. Kjo përzierje lihet në erërsirë dhe tundet çdo ditë derisa guaskat të treten. Më pas marrim dhe pimë 1 lugë gjelle në mëngjes e një në darkë, e do të vërejmë se së shpejti kocka do të fillojë të rikuperojë vetveten, ju do të ndjeheni më të fuqishëm dhe energjikë. Mëngjesi me tërshërë ndihmon që stomaku të fillojë punën menjëherë, organet e tjera rigjallërohen, pasi marrim

vitaminat e mineralet e duhura. Hidhet një gotë kos në një pjatë. Në të shtohet: 3-4 lugë tërshërë, 1 lugë gjelle fara liri, 1 lugë kafë shafran, 1 lugë kafë xhenxhefil dhe 1 lugë gjelle përzierje për osteoporozën. Shtoni në të 1 lugë mjaltë. Lihet përzierja 5 minuta të zbutet dhe konsumohet si mëngjes. Nëse tërshëra ju pëlqen më e zbutur, mund ta hidhni tërshërën në një kullësë çaji, shpëljani për rreth 1 minutë me ujë të nxehtë dhe pastaj shtojni në kos.

Çaji i reumatizmit

Ka aftësinë të ushqejë kockën, përmban shumë minerale dhe vitamina e mund të largojë acidin urik, që grumbullohet nëpër inde, muskuj dhe kyçe me kalimin e moshës. Nxit epitelin renal të veshkës që të largojë këtë acid urik dhe ta çojë atë brenda normës. Ndihmon në uljen e edemave nëpër kyçe dhe ul shkallën e dhimbjes në to. Përdorimi i çajit të reumatizmit, lule murri, këputjes, tërfilit dhe hithrës ndihmojnë në absorbimin e kalciomit në kockë. Çaji përdoret tri gota në ditë para ushqimit. Shoqërohet gjithashtu me ekstraktin e variceve dhe me vajin e sinapit. Në mëngjes bëhet një lyeje me ekstraktin e variceve për 2-3 minuta dhe pastaj bëhet masazh me vajin e sinapit për 5 minuta. Është mirë që ta lini trupin të lye me vajin përgjatë ditës, kështu ekstrakti dhe vaji do të veprojnë për 24 orë. Kjo bëhet vetëm për 4 ditë e para. Pas 4 ditësh do të lyheni me vajin vetëm në darkë.

Problemet me dëgjimin, si mund t'i parandaloni

Numri i personave që kanë probleme me dëgjimin ka ardhur duke u shtuar këto vitet e fundit. Kufjet që përdoren për të dëgjuar muzikë, mospastrimi, infeksionet, tensioni ose mungesa e një vizite te mjeku janë disa nga arsytet që ju rrezikojnë të prekeni nga sëmundjet e veshit. Mjekët këshillojnë që sapo të keni dhimbje në vesh, duhet të bëni një vizitë.

Shkaktarët

Ka dy mundësi kur vuani nga një dhimbje e papritur e veshit, ose keni një infeksion, ose një sëmundje që mund të keni në trup ju shkakton shqetësim. Në rastin kur keni infeksion, mënyra e vetme është vizita te mjeku dhe trajtimi i infeksionit duke bërë lavazh kanalit të veshit. Kjo mënyrë bën të mundur heqjen e infeksionit që mund të jetë mbledhur në zona të ndryshme. Më pas nëpërmjet një fitili, arrihet që të shpërndahet i gjithë infeksioni i mbledhur. Gjatë kësaj kohe nga mjekët do të merrni një recetë me antibiotikë për t'u kuruar dhe për të larguar përfundimisht infeksionin. Nëse një person ka dhimbje në vesh dhe shkon merr vetë ilaçe në farmaci, atëherë më shumë mundësi infeksioni do të shtohet dhe mund t'ju duhet një operacion për ta hequr. Për dhimbjet e veshit nuk ka qetësues që t'ju shërojë veç mjekut.

Mbrojtja

Nëse doni të mbron veshët, atëherë mos përdorni kufje për të dëgjuar muzikë. Një studim në Shtetet e Bashkuara ka zbuluar se kufjet dëmtojnë veshin me 30%, nëse atë përdoren rregullisht për një periudhë 6-mujore. Dëmtimin më të rëndë kufjet e shkaktojnë te fëmijët. Veshi i fëmijëve është shumë i ndjeshëm ndaj zhurmave, duke sjellë edhe dëmtimin e pjesshëm të tij. Gjithashtu, për të mbrojtur veshët duhet që t'i pastroni ata nëpërmjet kurave që ju jep doktori.

Zhurmat

Çdo person mund të vuajë edhe nga zhurmat në vesh. Përgjithësisht zhurmat vijnë nga dëmtimi i nervit të dëgjimit në veshin e brendshëm. Në disa raste



e domosdoshme që së pari të identifikohen problemet, në vend që të merren antibiotikë apo analgetikë për të evituar dhimbjen. Siç dihet, veshi ndahet në tri regjione: në veshin e jashtëm, të mesëm dhe të brendshëm. Këto tri pjesë punojnë së bashku për t'u kujdesur për balancën dhe dëgjimin e duhur. Për shembull, veshi i jashtëm tërheq valët e zërit që janë të ndara në vibrime dhe i kalon deri në veshin e brendshëm. Më pas veshi i brendshëm i shndërron vibrimet në impulse të nervave e që më pas udhëtojnë deri në tru. Veshi i brendshëm ka një kanal më të vogël që lidhet me hundën. Ky vendkalim i vogël është i njohur si kanali i Eustachian-it, funksioni i të cilit është të barazojë presionin në mes veshit të brendshëm dhe ambientit rrethues. Infeksionet bakteriale apo virale zhvillohen dhe rriten në kanalën e Eustachian-it, në veshin e brendshëm e që më pas kalon në një dhimbje brenda në vesh. Disa njerëz thonë se dhimbja e veshit është një nga llojet më të rënda të dhimbjes. Fatmirësisht ka ilaçe natyrore, të cilat e lehtësojnë shumë shpejt dhimbjen. Njëra prej tyre është hudhra, ku një thelb të saj e nxehti në vaj ulliri. E lini të ftohet, por jo plotësisht, pasi duhet të jetë pakëz i ngrohtë. Vajin e derdhni në vesh dhe e lini të qëndrojë 5-10 minuta, pastaj ktheni kokën në anë tjetër që vaji të dalë dhe gjatë kësaj kohe përdorni fashë, pecetë ose diçka që do të thithë vajin. Një tjetër ilaç është kanella. Përzini pak kanellë me vaj ulliri dhe pastaj nxeheni. Kur bëhet e nxehtë, largojeni nga zjarri dhe lëreni që të ftohet derisa të bëhet e vakët. Kulloni përzjerjen, ndërsa vajin e vëni në vesh. Lëreni të veprojë 5 deri 10 minuta.

SIMPTOMAT

- Dobësohet dëgjim
 - Keni marramendje
 - Keni temperaturë
 - Ndjeni goditje në vesh
- ÇFARË SHKAKTON INFEKSIONI NË VESH**
- Humbje e dëgjimit
 - Meningjit
 - Probleme me të folurën

këto dëmtime, nëse nuk kurohen, mund të sjellin edhe humbjen e dëgjimit te njëri vesh. Ekspozimi ndaj zhurmave me zë të lartë dhe barnat me efekte anësore anit-inflamatorët, antibiotikët, sedativët, barnat kundër depresionit dhe aspirina mund të shkaktojnë tinitus, apo zhurma në vesh, në njërin apo në dy veshët. Tinitusi mund të shkaktohet edhe nga faktorë të tjerë, si bllokimi i veshit, infeksionet e veshit apo sinusit, alergjitë, shtypja e lartë dhe e ulët e gjakut, tumoret, problemet në zemër, enët e gjakut, ndryshimet hormonale te femrat dhe anomali të gjëndrave tiroide. Por, është



Këshilla



Ja cilat janë 6 ushqimet më të mira për trurin

Disa ushqime kanë aftësinë të përmirësojnë mprehtësinë e mendjes dhe parandalojnë sëmundje të ndryshme neurologjike. Më poshtë do të gjeni të listuara 6 ushqimet më të mira për trurin në çdo moshë.

Rukola

Studimet konfirmojnë se njerëzit që hanë një ose dy racione me të gjelbra në ditë kanë aftësitë mendore të dikujt 11 vjet më të ri se ata që nuk konsumojnë barishte dhe perime të gjelbra. Rukola është një nga barishtet më të mira për trurin. Përbërësit e saj zgjerojnë enët e gjakut dhe përmirësojnë furnizimin e trurit me oksigjen.

Boronicat

Ky frut pylli është një nga ushqimet më të mira për trurin. Konsumi i boronicave ul rrezikun e Alzheimerit me 53 për qind. Sipas të dhënave, të gjitha frutat e pyllit janë të mira për shëndetin, por boronicat janë më të pasura me flavonoide. Këta të fundit janë antioksidantë që e mbrojnë trurin nga stresi oksidues e për më tepër ato forcojnë mjetet e komunikimit të qelizave të trurit.

E verdha e vezës

E verdha e vezës përmban vitaminë të kompleksit B, që përmirë-

sojnë shëndetin e trurit. Këto vitamina forcojnë kujtesën dhe ndihmojnë qelizat e trurit të komunikojnë në mënyrë më efikase.

Vaji i ullirit

Shkencëtarët konfirmojnë se konsumi i vajit të ullirit ekstra të virgjër mbrohet aftësitë kujtuese të trurit. Sipas informacioneve, të gjitha i atribuohet një antioksidantit të veçantë, të quajtur Oleocanthal, që gjendet te vaji i ullirit.



Salmoni

Ky peshk është i pasur me acidet yndyrore omega-3, që janë thelbësore për shëndetin e trurit. Këto acide yndyrore pakësojnë inflamacionin dhe stresin oksidues në tru. Ato gjithashtu kufizojnë tkurrjen e trurit si pasojë e moshës.

Arrat

Arrat përmbajnë acid alfa linoleik, një acid yndyror me bazë bimë. Ekspertët thonë se njerëzit që konsumojnë rregullisht arra janë më inteligjentë dhe më të mprehtë.



Efektet e mrekullueshme të vajit të peshkut në organizëm

Vaji i peshkut është një produkt ushqimor që kuron disa nga sëmundjet, të cilat jo rrallë herë sjellin edhe vdekjen. Vetitë e tij është shumë e vështirë t'i gesh në produkte të tjera ushqimore. Acidet yndyrore Omega-3 që ndodhen në vaj ndihmojnë në parandalimin e sëmundjeve të zemrës duke ulur rrezikun e forcimit të enëve të gjakut dhe nivelin e triglicerideve. Vaji i peshkut minimizon infeksionin e kyçeve dhe degjenerimin makular (sëmundje e syve). Është shumë i dobishëm sepse ekuilibron acidin yndyror Omega-3 me atë Omega-6. Kapsulat e vajit të peshkut nuk përmbajnë sodium. Ai është një produkt i sigurt për të gjithë, përfshirë këtu dhe gratë shtatzëna, duke i mbajtur sa më larg sëmundjes së Alzheimerit dhe depresionit. Vaji i peshkut është një produkt, i cili ka një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e shëndetit të organizmit tonë. Por, së fundi një shqyrtim i hulumtimeve sugjeron se vaji i peshkut mund të mbrojë edhe ndaj një vrasësi tjetër, kancerit të gjirit. Studiuesit kanë gjetur se një përdorim i lartë i vajit të peshku, jo domosdoshmërisht vetë peshku, dukej se ishte i lidhur me rrezik më të ulët të kancerit të gjirit më vonë gjatë jetës. Në mënyrë specifike ata kanë zbuluar se konsumi i lartë i acideve yndyrore që gjenden në vajin e peshkut ishte i lidhur me 14 për qind zvogëllim të rrezikut të kancerit të gjirit te gratë post-menopauze. Supplementet Omega-3 (që gjenden në vajin e peshkut) mund të ndihmojnë duhanpirësit që të heqin dorë nga ky ves. Sipas shkencëtarëve të Universitetit të Haifas në Izrael, ky acid yndyror ul nevojën për nikotinë. Duhanpirësit të cilëve iu dhanë çdo ditë kapsula Omega-3 përgjatë 1 muaji ulën dozën e konsumit të duhanit me 11 për qind.

I mbijetuari i dhunës së 1999-ës kujton sulmet kundër Serbisë

Haradinaj, letër Stoltenberg: Kosova, mirënjohëse ndaj NATO-s

Kryeministri kosovar kujton: Ndalën gjenocidin mbi popullin tonë

Ramush Haradinaj, kryeministri i Kosovës, ka thënë se ndërhyrja e forcave të NATO-s para 20 viteve ndali gjenocidin mbi popullin e Kosovës. Në një letër dërguar Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg, kryeministri Haradinaj tha se populli i Kosovës do të jetë gjithmonë falënderues për kontributin e NATO-s, për shpëtimin e mijëra jetëve dhe ndërtimin e paqes dhe stabilitetit në Kosovë. "Në njëzetvjetorin e ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë, ditën e shtunë i kam dërguar letër Sekretarit të Përgjithshëm të Paktit Veri-Atlantik, Jens Stoltenberg. Veprimi i vendosur i NATO-s para 20 viteve ndali aksionin gjenocidal mbi popullin e Kosovës. Kjo ndërhyrje u bazua mbi vlerat e lirisë, demokracisë dhe të drejtave të njeriut. Kosova është shtet i këtyre vlerave pa dallim dhe e vendosur në rrugën e integritimit euro-atlantik. Populli i Kosovës përherë do t'u jetë mirënjohës SHBA-ve dhe shteteve anëtare të NATO-s", tha Haradinaj. Ai gjatë ditës së djeshme ka bërë homazhe edhe pranë pllakës memoriale të ushtarëve të KFOR-it, të rënë gjatë shërbimit në Kosovë, si dhe të pllaka përkujtimore me emrat e ushtarëve britanikë, që humbën jetën në shërbim në Kosovë. Dje, më 24 mars, u bënë 20 vjet nga fillimi i bombardimeve të NATO-s mbi caqet e ish-Jugosllavisë. Fushata që i dha fund luftës në Kosovë, zgjati 78 ditë.

Të mbijeturit e dhunës së forcave serbe kujtojnë 24 marsin 1999. Në mesin e shumë shqiptarëve të plagosur natën e 24 marsit të vitit 1999, i shtrirë në spitalin e Prishtinës ishte edhe Nexhi Azemi. Azemi kur kthehet 20 vjet pas, atë mbrëmje e kujton si të kobshme, por thotë se u kthye në natë gëzim, raporton "KTV". Ai rrëfen tronditjen që kishin përjetuar kur kishin dëgjuar krismat, të cilat nuk e dinin se nga kush vinin. Fatin e Azemit që t'u mbijetoië plagëve nuk e kishte edhe vëllai i tij, i cili u vra nga forcat paramilitare serbe. Pas natës së parë të bombardimeve të NATO-s, forcat serbe kishin nisur ashpërsimin e sulmeve ndaj popullatës civile shqiptare. Mëngjesin e 25 marsit, ata vranë 15 persona vetëm në qytetin e Podujevës, ku dy nga ta vazhdojnë të jenë të zhdukur. Gjatë 78 ditëve sa zgjatën bombardimet e NATO-s, forcat policore e ushtarake serbe vranë



Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj

mijëra civilë shqiptarë, derisa rreth 1 mijë e 600 persona ende janë të zhdukur. Ndërkaq sipas 'BBC'-së, dita e parë e bombardimeve të NATO-s ndaj forcave serbe

në 1999-ën ka kushtuar më shumë se 38 milionë euro. Sulmet filluan në orën 19:45, kur aeroplanët e NATO-s lëshuan raketat e para kundër pozicioneve

strategjike të ushtrisë së ish-Jugosllavisë, siç quheshin dy republikat e ish-federatës jugosllave, Serbia dhe Mali i Zi. Urdhri për fillimin e fushatës bombar-

RAMUSH HARADINAJ
"Veprimi i vendosur i NATO-s para 20 viteve ndali gjenocidin mbi popullin e Kosovës. Kjo ndërhyrje u bazua mbi vlerat e lirisë, demokracisë dhe të drejtave të njeriut. Kosova është shtet i këtyre vlerave pa dallim dhe e vendosur në rrugën e integritimit euro-atlantik. Populli i Kosovës përherë do t'u jetë mirënjohës SHBA-ve dhe shteteve anëtare të NATO-s", tha Haradinaj.

ku ishte urdhëruar Aleancën Atlantike të fillonte operacionin ushtarak, si mundësi e vetme e përfundimit të luftimeve në Kosovë. "Ne dhe NATO kemi bërë të gjitha përpjekjet, me qëllim që të arrinim një zgjidhje paqësore të konfliktit në Kosovë. Por, presidenti Milloseviç, i cili në të kaluarën e afërt shkaktoi luftëra të tmerrshme në Kroaci e në Bosnjë, ka vendosur në favor të agresionit në vend se të paqes", ka thënë presidenti Clinton. Sulmet ajrore kundër forcave serbe e malazeze vazhduan deri më 9 qershor, kur u arrit Marrëveshja e Kumanovës, e cila ndryshe njihet edhe si kapitullimi i kriminelit Milloseviç dhe më 11 qershor forcat e armikut filluan ta lëshojnë territorin e Kosovës. Kjo është ndërhyrja e parë ushtarake e NATO-s që nga formimi i saj, e cila njihet edhe si ndërhyrja historike.

Serbi/ Viojnë protestat kundër Vuçiçit, afat deri në 13 prill

Protestat në Serbi me moton "1 në 5 milionë" kanë vazhduar edhe ditën e shtunë kundër presidentit Aleksandër Vuçiç. Shumë qytetarë u mbledhën përpara Fakultetit Filozofik në Beograd, të cilët kërkuar dorëheqjen e presidentit Vuçiç dhe mbajtjen e zgjedhjeve të reja. "Nëse kërkesat tona nuk plotësohen, e tërë Serbia do të mbledhet më 13 prill kundër uzurpuesve", ka thënë një nga organizatorët e protestës. Pas kësaj, është mbajtur një minutë heshtje për viktimat e bombardimeve të ndërhyrjes së NATO-s. "Tani kam më shumë frikë sesa në vitin 1999-ën. Ju faleminderit, jeni frymëzim për të luftuar në një formë tjetër", tha Lečić. Ai kërkoi nga qytetarët që të mos shkaktojnë dhunë gjatë protestës. Pak policë dhe shumë e qetë ka nisur protesta kundër presidentit serb, Aleksandar Vuçiç dhe qeverisjes së tij ditën e djeshme. Në fillim ka qenë më e fuqishme, por duket se ka ndryshuar koreografia e protestave ashtu si dhe muzika. Pas incidenteve të javës së shkuar dhe hyrjes në televizionin publik, protestuesit kanë dalë sërish në shesh. Kësaj radhe para tyre nuk kanë dalë politikanët, por një aktor që ka udhëhequr edhe dikur protestat në vitet '90 dhe ish-shefi i avionit serb në kohën e bombardimeve, që janë kundër presidentit. "E shikoni se 23 vjet luftë jemi duke bërë me të njëjtat fjalë dhe me të njëjtat kërkesa dhe dua që të rinjtë dhe Serbia e shpërses të thonë fjalën e tyre", tha Branislav Llekic, aktor dhe aktivist. Ndërsa Sreto Maillinovic, gjeneral në pension tha: "Shikoni se kush e udhëheq shtetin, një grup pa ideale që flasin për Bashkimin Evropian dhe rrethojnë njëkohësisht çdo shtyllë të këtij shteti". Ata u nisën edhe një herë në rrugët e kryeqytetit për tri orë dhe drejt institucioneve të rëndësishme në Beograd. Protestat thonë se nuk i ndalojnë, por dhuna nuk është autorësi e tyre. Protesta vazhdoi pa incidente, pavarësisht se protestuesit ndaluan para televizionit publik për disa orë, duke lexuar lajmet alternative. Lule për viktimat e rëna në luftë nga aktivistët e rinj për shumicën e protestuesve. Më pas edhe qirinj për ta ndriçuar televizionin, që thonë se i mban në errësirë informative. Vuçiç është i mbaruar, i kanë sugjeruar me brohoritje. Një pjesë e të burgosurve janë liruar, por një pjesë janë në burg. Vuçiç ka afat dy javë dhe më 13 prill kanë ftuar protestat e tërë Serbisë në kryeqytet për të kërkuar dorëheqjen e tërë krerëve të shtetit.



Kreu i Kishës Ortodokse serbe: Kosova është 'Jerusalemi' ynë

Kreu i Kishës Ortodokse serbe, patriarku Irinej, mendon se Kosova është 'Jerusalemi', serb nga e cila nuk do të heqim dorë kurrë. Patriarku serb ndër të tjera beson se Rusia në kohë të vështira do ta ndihmojë gjithmonë Serbinë të ruajë Kosovën, raporton "Beta". "Rusët janë popull i madh dhe fuqishëm, ne jemi të vegjël, por fatmirësisht gjithmonë barkën tonë e kemi lidhur me anijen e madhe ruse", është shprehur sot patriarku i kishës serbe. Ndër të tjera, patriarku Irinej mendon se Serbia sot është në pozitë shumë të vështirë, por që kjo gjë mund të ndryshojë me ndihmën e Rusisë.

Ish-ministri i Thaçit: Presidenti e ka hequr rolin e unifikuesit

Rexhep Selimi, dikur ministër i Punëve të Brendshme

në qeverinë e pasluftës së udhëhequr nga Hashim Thaçi, po vazhdon të lëshojë akuza në drejtim të presidentit. Ai ka thënë se Thaçi s'është president i tij dhe as i qytetarëve. Sipas tij, shefi i shtetit ka dështuar të jetë përfaqësues i unitetit të popullit. Selimi ka kujtuar edhe momentin kur sipas tij, Thaçi ka dështuar se nuk është president i qytetarëve të vendit. "Në fakt për mua, ai nuk është një president. Për mendimin tim, nuk është presidenti i të gjithëve, sepse presidenti rolin e vet kushtetues e ka që të jetë president i të gjithë shqiptarëve, të jetë përbashkues i të gjitha subjekteve politike, të jetë figurë uniteti", ka thënë Selimi.

REXHEP SELIMI

"Në fakt për mua ai nuk është një president. Për mendimin tim, nuk është presidenti i të gjithëve, sepse presidenti rolin e vet kushtetues e ka që të jetë president i të gjithë shqiptarëve, të jetë përbashkues i të gjitha subjekteve politike, të jetë figurë uniteti", ka thënë Selimi.

Në fakt për mua ai nuk është një president. Për mendimin tim, nuk është presidenti i të gjithëve, sepse presidenti rolin e vet kushtetues e ka që të jetë president i të gjithë shqiptarëve dhe po ashtu të jetë bashkues i të gjitha subjekteve politike, të jetë figurë uniteti. Ky ka të kundërtën, as nuk është president i të gjithë qytetarëve të Kosovës, e mbi të gjitha nuk është figurë uniteti, është figurë ndarëse. Madje, edhe momenti i zgjedhjes së tij ka qenë pa opozitën, duke e nxjerrë atë nga Kuvendi me polici. Dhe që nga ai moment, nuk është as president i imi, as i atyre që i ka nxjerrë jashtë e as president i atyre votuesve të atyre deputetëve, që janë nxjerrë zvarrë nga Kuvendi për t'u zgjedhur ky njeri si president", ka thënë ai. Ai thotë se këtë veprim presidenti Thaçi ta ketë pasur përtej personales, pasi sipas Selimit, ka edhe plane të tjera, të cilat po i shpallon me qasjen ndaj dialogut, kufirit dhe territoreve.

Ngritja dhe rënia e 28 vendeve, si parashikohet e ardhmja jonë

Viti 2019, a po shkojmë drejt fundit të qytetërimit?

"Shterimi i përkohshëm", ja nga ç'vuan shoqëria moderne

Nga Luka Kemp

Shoqëria moderne po vuan nga "shterimi i përkohshëm", tha në një rast sociologia Eliza Bulding. "Nëse dikush ka mbetur i asfikuar nga ballafaqimi me të tashmen, ai nuk ka më energji për të imagjinuar të ardhmen", - shkruante ajo. Në të njëjtin përfundim arriti historiani Arnold Tojnb, në librin e tij voluminoz "Një studim i historisë", ku analizon ngritjen dhe rënien e 28 qytetërimeve të ndryshme. Ai kishte të drejtë në disa aspekte: qytetërimet janë shpesh vetë përgjegjëse për rënien e tyre. Sidoqoftë, zakonisht vetëshkatërimi i tyre ndihmohet. Për shembull, Perandoria Romake ishte viktimë e shumë "sëmundjeve", duke përfshirë zgjerimin e tepër, ndryshimet klimatike, degradimin e mjedisit dhe udhëheqjen e dobët. Por ajo u gjunjëzua, kur Roma u pushtua dhe u plaçkit nga Visigotët në vitin 410 dhe Vandalët më 455. Kolapsi është shpesh i shpejtë dhe madhështia nuk siguron ndonjë imunitet. Perandoria Romake shtrihej në një sipërfaqe prej 4.4 milionë km² katrorë në vitin 390. Pesë vjet më vonë, ajo u rrudh në 2 milionë km². Nga viti 476, shtrirja e perandorisë ishte zero. Çfarë mund të na tregojë ngritja dhe rënia e qytetërimeve historike, mbi qytetërimin tonë aktual? Cilat janë forcat që përshejtojnë, ose vonojnë një rënie? A shohim sot modele të ngjashme? Mënyra e parë, për të analizuar qytetërimet e kaluara është krahasimi i jetëgjatësisë së tyre. Rënia mund të përkufizohet si një humbje e shpejtë dhe e qëndrueshme e popullsisë, e identitetit dhe e kompleksitetit socio-ekonomik. Shërbimet publike shkërmoqen vjen kaosi dhe qeveria humb kontrollin e monopolit të saj mbi dhunën. Gati të gjitha qytetërimet e kaluara janë përbërur nga këto fat. Disa janë rigritur dhe transformuar, sic janë kinezët dhe egjiptianët. Rënie të tjera kanë qenë të përhershme, sic ishte rasti i Ishullit të Pashkëve. Ndonjëherë qytetet në epiqendrën e rënies ringjallen, sic ishte rasti i Romës. Në raste të tjera, si qytetërimi i Majave, qytetet u braktisën si mauzoleume për turistikë e ardhshëm. Shoqëritë e së kaluarës dhe të tashmes janë thjesht sisteme komplekse, të përbëra nga njerëzit dhe teknologjia. Teoria e "aksidenteve normale" sugjeron që sistemet komplekse teknologjike



dështojnë vazhdimisht pas një fare kohe. Pra, rënia mund të jetë një dukuri normale për qytetërimet, pavarësisht nga madhësia dhe pozita e tyre. Sot ne mund të jemi më të përparuar në aspektin teknologjik. Por kjo nuk jep shumë arsye për të besuar se jemi të imunizuar ndaj kërcënimeve, që i kanë rrëzuar paraardhësit tanë. Aftësitë tona teknologjike të sapoformuara, sjellin edhe sfida të reja dhe të pashembullta. Sistemi ynë ekonomikisht i bashkuar dhe i globalizuar ka më shumë gjasa të shkaktojë përhapjen e krizës. Përdërisa nuk ekziston një teori e vetme e prastuar, se përse shemben qytetërimet, historianët, antropologët dhe të tjerët kanë propozuar shpjegime të ndryshme, duke përfshirë: Ndryshimet klimatike: Kur ndryshon stabiliteti klimatik, pasojat mund të jenë katastrofale, duke sjellë prishjen e të mbjellave, uri masive dhe shkretëtirëzimin e tokave. Rënia qytetërimeve Anasazit, Tiuanaku, Akadian, Majan, Perandorisë Romake dhe shumë të tjerave kanë përkuar të gjitha me ndryshime klimatike të papritura, zakonisht thotë. Degradimi mjedisor: Kolapsi mund të ndodhë, kur shoqëritë tejkalojnë kapacitetin mbajtës të mjedisit të tyre. Pabarazia dhe oligarkia: Pauria dhe pabarazia politike mund të jenë nxitësit qendrorë të shpërbërjes sociale, ashtu si oligarkia dhe centralizimi i pushtetit midis udhëheqësve. Kjo, jo vetëm që shkakton shqetësime so-

cialë, por e pengon aftësinë e një shoqërie, për t'iu përgjigjur problemeve ekologjike, sociale dhe ekonomike. Komplexiteti: Historiani Xhozef Tainter ka propozuar se shoqëritë në fund shemben nën peshën e kompleksitetit dhe burokracisë së tyre të akumuluar. Tronditjet e jashtme: luftërat, fatkeqësitë natyrore, uria dhe plagët. Për shembull, perandoria Azteke u pushtua nga spanjollë. Ndërsa shumica e shteteve të hershme agrare u zhdukën për shkak të epidemive vdekjeprurëse. Rastësia ose fati: Analiza statistikore mbi perandoritë sugjeron se kolapsi është i rastësishëm dhe i pavarur nga vjetërsia e tyre. Biologu i evolucionit dhe shkencëtari i të dhënave, Indre Zliobaite dhe kolegët e tij kanë vërejtur një model të ngjashëm në regjistrimin evolucionar të specieveve. Një shpjegim i zakonshëm i kësaj rastësie të dukshme është "Efekti i Mbretëreshës së Kuqe": nëse speciet luftojnë vazhdimisht për mbijetesë, në një mjedis të ndryshueshëm me konkurrentë të shumtë, zhdukja është një mundësi e qëndrueshme. Me gjithë bollëkun e librave dhe artikujve, ne nuk kemi një shpjegim përfundimtar pse shemben qytetërimet. Për qytetërimin e sotëm përdoren këto 4 metrika të mundshme, të matura gjatë dekadave të fundit. Temperatura është një metrikë e qartë për ndryshimet klimatike, PBB është një ndihmëse e kompleksitetit dhe aspekti ekologjik është një

tregues për degradimin e mjedisit. Pabarazia është më e vështira për t'u llogaritur. Matja tipike e Indeksit Gini sugjeron që pabarazia është zvogëluar paksa në nivel global, ndërsa është rritur brenda vendeve. Më e rëndësishmja: pabarazia e pasurisë është edhe më e madhe. Lajmi disi qetësues, është se metrikat e kolapsit, nuk përbëjnë të gjithë tablonë. Rezistenca sociale, mund të jetë një gjendje të vonojë ose të parandalojë rënien. Për shembull, diversiteti ekonomik, është më i madh sot sesa në vitet 1960 dhe 1970. Megjithatë, bota po përqësohet në fushat që kanë kontribuar në shembjen e qytetërimeve të mëparshme. Klima po ndryshon, hendeku midis të pasurve dhe të varfërve po zgjerohet, bota po bëhet gjithnjë e më komplekse dhe kërkesat tona për mjedisin po tejkalojnë kapacitetin mbartës të planetit. Sot kolapsi shoqëror është një perspektivë më e pabesë.

Armët në dispozicion të një shteti, dhe nganjëherë edhe grupeve gjatë një kaosi, tani variojnë nga agjentët biologjikë, tek armët bërthamore. Lufta bërthamore në vetvete, mund të rezultojë në një rrezik ekzistencial: ose zhdukjen e specieveve tona, ose një katapultim të përhershëm sërish në Epokën e Gurit. Në rastin tonë, rënia, do të ishte një kurth i përparimit. Rënia e qytetërimit tonë, nuk është e pashmangshme. Historia sugjeron se ka të ngjarë, por ne kemi një përparësi unike të të qenit në gjendje të mësojmë nga gabimet e shoqërive të kaluara. Ne e dimë se çfarë duhet bërë: emetimet e gazrave sërë në atmosferë mund të reduktohen, pabarazitë të ngushtohen, degradimi i mjedisit të ndalet, që inovacioni të ketë bumin e rradhës dhe ekonomitë të diversifikohen. Propozimet konkrete janë në tavolinë, mungon vetëm vullneti politik. Marrë nga "Bota.al"

SHKURT

Afrikë Jugore, rritet numri i viktimave pas ciklonit

Numri i viktimave nga cikloni "Idai", që përfshiu Afrikën Jugore më shumë se një javë më parë ka shënuar rritje, thanë autoritetet për "BBC". Numri i personave të raportuar të vdekur në Mozambik është rritur nga 242 në 417. Ndërkaq, numri total i viktimave në Mozambik, Zimbabve dhe Malavi ka arritur në 700. Kjo shifër pritet të rritet edhe më shumë. Kombet e Bashkuara deklaruan se do të mund të paraqesin shifrën e saktë vetëm kur të qetësohet vërshimi i ujërave. Zyra e OKB-së për Koordinim dhe Çështje Humanitare dhe se lumenjtë janë në rrezik të daljes nga shtrati sërish. Mijëra persona kanë mbetur të ngujuar nga vërshimi i lumenjve, derisa po bëhet përpjekje për të siguruar ndihma ushqimore. Rreth 1.7 milionë persona thuhet të jenë pa energji elektrike si dhe kanë pësuar dëme të mëdha.

Angli, manifestim i madh anti-Brexit

Manifestim kaq të madh, Londra nuk kishte parë prej vitesh, të paktën prej 2003-shtit kur kundërshtojë pjesëmarrja e ushtrisë britanike në sulmin ndaj Irakut. Rreth një milion njerëz, po aq sa në atë kohë, morën pjesë në manifestimin ku kërkohet një referendum i dytë me shpresën për të penguar daljen e Britanisë nga Bashkimi Europian. "Lëre popullin të vendosë" ishte slogani i manifestimit, një thirrje që organizatorët i drejtuan kryeministres May, për ta hedhur marrëveshjen me Brukselin në referendum, pasi nuk po siguron shumicën në parlament. Tom Watson, nënkryetar i laburistëve tha: "Mënyra për të kapërcyer ngërçin është që populli dhe parlamenti të flasin në një zë. Është koha për ta thënë me një zë, 'Lëre popullin të vendosë'". Kryeministres May i duhet ta hedhë për të tretën herë marrëveshjen me Brukselin në votim në parlament. Kreu i domos së ulët nuk pranoi ta shtrojë për diskutim të njëjtin marrëveshje që përmban lëshimet e bëra nga Brukseli, por që u refuzuan në votimin e dytë. Bashkimi Europian pranoi të shtyjtë afatin e Brexittit deri më 22 maj, për t'i lënë kohë May të bindë deputetët rebelë brenda konservatorëve. Liderët e BE-së nuk pranojnë të bëjnë lëshime të tjera. Mediat britanike shkruajnë se një nga kushtet që deputetët rebelë kanë vënë është dorëheqja e kryeministres sapo marrëveshja të miratohet.



NORVEGIJ, TRAGETI RREZIKOI TË MBYTJEJ

Trageti norvegjez "Viking Sky" është bllokuar në mes të detit të trazuar prej të shtunës me mbi 1300 persona në bord. Marinarët lëshuan sinjalin e alarmit rreth orës 2 të drekës së të shtunës, pas daljes jashtë funksionimit të motorëve, për shkak të motit të keq dhe dallgëve që arrinin deri 8 metra lartësi. Trageti rrezikonte mbytjen, pasi dallgët mund ta përplasnin me disa shkëmbinj detarë. Autoritetet po përdorin helikopterë për të evakuuar pasagjerët nga bordi. Deri më tani janë shpëtuar rreth 500 persona.

Opinioni **i Ditës**

18 maji i dytë ose: E bën dot Feniksin?

Nga Fatos Çoçoli

(vijon nga faqja 1)

...se dy vjet pati vlera të jashtëzakonshme për dheun tonë, Shqipërinë. Së pari, vendosi qetësinë sociale. Vendi ishte në prag të një gjendjeje shumë të rrezikshme, me opozitën kryesore të vendit, që pas rezistencës disamujore në rrugë përpara Kryeministrisë në formën e një çadre gjigante, ishte e vendosur jo vetëm të mos merrte pjesë në zgjedhjet e përgjithshme të 25 qershorit 2017, por edhe të ndërhynte për t'i prishur ato. Një skenar ogurzi që kishte tensionuar gjithkënd dhe ekonomia kishte filluar ta ndiente në prenotime tejet të pakta turistike dhe stepje investimesh private. Së dyti, marrëveshja prodhoi sigurinë që ekonomia e gjithë shqiptarëve të zhvillohej pa kriza politike për periudhën shtator 2017-janar 2019. Së treti, realizuam zgjedhjet më të qeta dhe fillimisht të pakundërshtuara fort në historinë e zgjedhjeve pluraliste, pas atyre të 22 marsit 1992. Zgjedhjet u kundërshtuan vetëm këtë periudhën e fundit si të blera masivisht, për arsye të tjera. Nuk ka rëndësi bilanci i përfitimeve apo humbjeve partiake të marrëveshjes së 18 majit. Ajo funksionoi dhe na ndihoi të gjithëve. Tani kërkojmë një marrëveshje të dytë si ajo. Kuptohet, nuk do të jetë asfale e ngjashme, nëse do të arrihet një ujdë e dytë. Mirëpo një marrëveshje të dytë e kërkon dëshpërueshmërisht edhe opozita. Pavarësisht se sot bën të fortën dhe të vendosurën ta çojë vendin në greminë, në emër të gjoja votës së lirë. Duhet përfutur nga kjo pritshmëri si ndër ethe e saj. Socialistët dy ditë më parë bënë lojën e tyre. Shfrytëzuan kongresin e radhës për të bërë një manifestim në rrugë. Një demonstrim forçe dhe mbështetjeje nga populli. Treguan popullin pozitiv, i cili, pikërisht nga vepri i pashoq i opozitës i 19 shkurtit, duke refuzuar përfaqësimin në Kuvend, nuk përbehej vetëm nga punonjësit e Bashkisë së Tiranës apo të bashkive të tjera kryesore që i kanë socialistët. Socialistët kanë një bazë të gjerë në disa shtesa të popullsisë, gjithnjë besnike ndaj kësaj partie. Sidomos tek pensionistët. Një pjesë jo e vogël e tyre, në mos shumica, janë të galvanizuar nga politikat populiste të kryetarit të sotëm të kësaj forçe politike dhe kryeministër i vendit (të tipit qeverisja me qytetarin). Mbështetja tradicionale duket se është rritur për partinë në pushtet, me gjithë skandalet e herëpashershme, sidomos me tenderin e fundit të kompanisë fantazmë fituese, apo protestën e studentëve. Një forçe politike në zenitin e fuqisë së saj duhet të ndajë pushtet dhe të delegojë shpresa edhe të pakta opozita e telendisur që ka përpara vetes. Ndryshe kthehet në një grusht të verbër autoritar. Kryetari i saj ka treguar se e ka aftësinë t'u dalë përpara situatave minuese, të tilla si pakënaqësia popullore për mundësinë e sjelljes së armëve kimike nga Siria në nëntor 2013, apo protesta e studentëve në dhjetor 2018. Ndoshta asi nën mëngë nuk është vetëm



Marrëveshja historike e 18 majit 2017 mes drejtuesve të dy partive kryesore të vendit vendosi qetësinë sociale. Vendi ishte në prag të një gjendjeje shumë të rrezikshme, me opozitën kryesore të vendit, që pas rezistencës disamujore në rrugë përpara Kryeministrisë në formën e një çadre gjigante, ishte e vendosur jo vetëm të mos merrte pjesë në zgjedhjet e përgjithshme të 25 qershorit 2017, por edhe të ndërhynte për t'i prishur ato. Një skenar ogurzi që kishte tensionuar gjithkënd dhe ekonomia kishte filluar ta ndiente në prenotime tejet të pakta turistike dhe stepje investimesh private. Së dyti, marrëveshja prodhoi sigurinë që ekonomia e gjithë shqiptarëve të zhvillohej pa kriza politike për periudhën shtator 2017-janar 2019. Së treti, realizuam zgjedhjet më të qeta dhe fillimisht të pakundërshtuara fort në historinë e zgjedhjeve pluraliste, pas atyre të 22 marsit 1992. Zgjedhjet u kundërshtuan vetëm këtë periudhën e fundit si të blera masivisht, për arsye të tjera. Nuk ka rëndësi bilanci i përfitimeve apo humbjeve partiake të marrëveshjes së 18 majit. Ajo funksionoi dhe na ndihoi të gjithëve.

propozimi që me një bashki më shumë në numër të opozitës nga sa do të marrin socialistët në 30 qershor 2019, të shkohet në vjeshtë në zgjedhje të parakohshme. Edhe pse ky përbën një lëshim të madh (asnjë nga partitë e mëparshme në pushtet nuk e ka prodhuar këtë propozim pak muaj përpara zgjedhjeve vendore). Interesat e vendit kërkojnë diçka më shumë. Një aleat i vogël i PS-së në një studio televizive formuloi një ide të tillë: "Lësho edhe më shumë pe, lejo formimin e një qeverie socialiste pa ty si kryeministër dhe drejto

partinë në fitoren e zgjedhjeve të përgjithshme e vendore bashkë në vjeshtë, duke betonuar pozicionin si kryeministër për katër vitet e ardhshme". Nëse ideali i të bërit shtet dhe ndryshim epokal për shqiptarët është real në mendjen e kryeministrit më të sulmuar të këtyre 29 viteve tranzicioni, edhe mund të provojë të bëjë Feniksin (zogun mitologjik që ringjallet nga hiri i tij). Një njëri që ka lexuar qartjet e 12 mijë qytetarëve shqiptarë në 5 vitet e fundit nga celulari i vet, mund të bëjë gjëra. Dorashkë për dorashkë. Nëse opozita u vetëdij

në parlament, kryeministri mund të "vetëdijet" në qeverisje, për të rilindur sërish (për më tepër që e ka aq me qejf fjalën rilindje) në vjeshtë me fitimin e zgjedhjeve dyfishe: vendore të radhës dhe të përgjithshme të parakohshme. Vepri i pamundur? Jo rrallë nga situatat e pamundura dalin ujditë historike. Edhe marrëveshja e 18 majit 2017 dukej e pamundur deri mbremjen e datës 17 maj 2017, kur kryetari i socialistëve kthehej së bashku me çitjanet e tij nga një takim me gratë socialiste në Elbasan.

HOROSKOPI

DASHI

Sot do të keni të gjitha mundësitë për të mirur të ardhurat financiare. Kjo mund të vijë si pasojë e një projekti të huaj. Sa u përket marrëdhënieve personale duhet të kufizoheni nga bisedat intime, deklaratat e dashurisë, pasi nuk është dita e duhur.

DEMI

Për disa Dema, kjo ditë do të nisë lehtësisht. Keni mundësi të realizoni plotësisht planet për ditën e sotme. E vetmja gjë që mund t'ju sjellë probleme janë bisedat me një prej kolegëve tuaj. Mund të realizoni një takim të mrekullueshëm në mbrëmje.

BINJAKET

Binjakët mund të marrin disa lajme befasese këtë të hënë. Kjo ka gjasa të ketë lidhje me bizneset personale, financa ose karrierën. Sa i përket jetës personale, nuk pritet të ndodhë asgjë në veçanti. Qëndroni larg dietave strikte apo eksperimenteve në kulinari.

GAFORJA

Gaforret mund të konfuzohen nga informacionet gjatë ditës së sotme. Mund të merrin disa lajme zhgënjyese sa i përket biznesit apo lidhjeve suaj romantike. Mbani nën kontroll situatën dhe vëzhgoni me kujdes dinamikën e marrëdhënieve tuaja.

LUANI

Luanët do grinden paksa sot. Kjo mund të vijë për shkak të veshjes, stilit të flokëve apo sjellje së dikujt që nuk do t'ju pëlqejë. Mos u kushtoni rëndësi këtyre çështjeve dhe ecni përpara. Në jetën profesionale do të shënoni sukses.

VIRGJERESHA

Do të kaloni një ditë aspak monotone. Do të bëni lojëra, shaka me miqtë, po ka gjasa edhe të flirtoni me seksin e kundërt. Nuk rekomandohet të ndërmerri projekte të rëndësishme gjatë ditës së sotme. Në mbrëmje këshillohet të tregoni kujdes ndaj familjes.

PESHORJA

Disa Peshore do të jenë plot me ide të pazakonta. Nuk rekomandohet t'i ndani këto ide me njerëz që janë me këmbë në tokë. Shmangni bisedimet e teprta për të ardhmen në familje, deklaratat e dashurisë dhe projektet në grup.

AKREPI

Do të përjetoni surpriza të ndryshme gjatë kësaj të hëne, të cilat mund të vijnë nga njerëz që keni pasur një marrëdhënie të ftohtë në të kaluarën. Kjo ditë është e duhur për të bërë marrëveshje apo për të kërkuar një punë të re.

SHIGJETARI

Shigjetarët mund të befashohen sot nga vepri i disa personave pranë tyre. Ka gjasa që të ndiheni të tradhtuar. Arsyetja kryesore mund të jetë ardhja e një konkurenti në punën tuaj. Mos u përqipni të luftoni me problemet që do të përballeni këtë të hënë.

BRICJAPI

Bricjapët duhet të bëjnë kujdes me financa! Mos u bëni pjesë e aventurave të miqve tuaj. Gjithashtu, bëni shumë kujdes tek sa ngisni makinën ose me pajisjet elektrike. Mbrëmja premon të kalojë pa probleme.

UJORI

Ujorët do të kenë fat me financa, por edhe në çështjet profesionale. Ka gjasa që të fitoni një rrjetë të vogël page. Sa u përket takimeve romantike apo diskutimeve në familje, nuk është dita e duhur. Kushtojni rëndësi kujdesit ndaj shëndetit.

PESHQIT

Disa Peshq do të shënojnë sukses gjatë kësaj të hëne. Mund të provoni fatin në biznes ose të mendoni rreth mënyrave për të fituar më shumë të ardhura. Është koha e duhur për të ndërtuar dashurinë.

KOMBËTARJA U19

Shqipëria barazon 1-1 me Maqedoninë e Veriut

Pasditën e djeshme zbriti në fushë edhe Kombëtarja Shqiptare U19, që u përball në një takim miqësor me të njëjtën grupmoshë të Maqedonisë Veriore, në sfidën e luajtur në stadiumin "Skënderbeu" të

qytetit të Korçës. Ndryshe nga Kombëtarja e madhe dhe U21-shi, 19-vjeçarët nuk u mposhtën, pasi sfida ndaj fqinjëve maqedonas përfundoi në barazim 1-1. Ishin 19-vjeçarët nga

Maqedonia e Veriut, ata që kaluan të parët në avantazh, në minutën e 12 me anë të Todorovskit, ndërsa skuadra e drejtuar nga Nevil Dede barazoi me Brojën në pjesën e dytë.

KATEGORIA SUPERIORE

Rifillon Superliga, ja grafiku i ndeshjeve të javës

Pas pauzës për ndeshjet e Kombëtares shqiptare, Kategoria Superiore rikthehet fundjavën tjetër me Federatën Shqiptare të Futbollit, që ka përcaktuar edhe kalendarin e javës së 26-të, e cila do të luhet në dy ditë të premtën dhe të shtunën. Supersfida që do të përcaktojë edhe

një pjesë të mirë të fateve për sa i përket titullit kampion, ajo mes Kukësit dhe Partizanit do të zhvillohet të premtën në orën 18:00, për të marrë të gjithë vëmendjen e mundshme.

SUPERLIGA	
TE PREMTËN	
Kukësi-Partizani	18:00
TE SHTUNËN	
Luftitari-Skënderbeu	14:00
Tirana-Laci	17:00
Teuta-Kastrioti	17:00

Tekniku kryeqytetas, në mëdyshtje për Kristian Panuçin: Erdhi se ishte i mirë, apo i lirë?

Josa: U nxituam me Panuçin, trajneri i ri të jetë i huaj

Trashëgimia e De Biazit është e rëndë për këdo



Jeton Selimi

Shkarkimi i Kristian Panuçit nga posti i trajnerit të Shqipërisë, padyshim që ka qenë ngjarja më e rëndësishme sportive në vend në ditët e fundit. Në lidhje me shkarkimin e tij, gjendjen aktuale të skuadrës dhe atë që Kombëtares i mungon, në një intervistë për "VipSport.al", ka folur trajneri Mirel Josa, i cili aktualisht drejton Prishtinën në Kosovë. Josa shprehet se me Panuçin është gabuar në fillim, ndërkohë që ka edhe një këshillë për kërkesat që bëhen karshi ekipit apo individëve. Sakaq, Josa ka analizuar edhe ndeshjen e fundit ndaj Turqisë, duke nxjerrë në pah gabimet që Kombëtarja ka bërë.

Profesor, shkarkimi i Panuçit pas humbjes me Turqinë erdhi në kohën e duhur, apo jo?

Unë nuk kam kompetenca të them nëse ishte apo jo zgjedhje e duhur, pasi vendos tjetërkush për këtë. Unë mund të them se duhet treguar kujdes që në fillim kur është zgjedhur trajneri për herë të parë, direkt pasi iku De Biazit. Duhet të



ishim të kujdesshëm edhe për të kuptuar nëse ka bërë mirë apo keq Panuçi që është larguar, pasi në ende kemi frymën e "Euro 2016" dhe mendojmë se jemi në të njëjtën gjendje si atëherë. Ne kemi pasur ndryshime dhe oshilacione të ndryshme. Ishte vetëm ndeshja e parë dhe unë e dija, e isha i bindur se Turqia do të

vinte me një fytyrë tjetër në këtë ndeshje. Skuadra kam probleme në mbrojtje dhe mjafton të shihet goli i parë, që është plotësisht amatoresk. Thonë se e ka fajin Xhaka, por ai është i fundit që ka faj në atë gol. Gabimi ishte që në momentin e kthimit të topit të Berisha dhe pasi e mori Gjishiti, duhet t'i jepte

zgjidhje situatës, por gaboi dhe pësuam. Pashë një çorëganizim në mbrojtje. Edhe sulmi duhet të bënte zgjidhje ndryshe, por nuk i vë shumë faj, pasi kur pëson në fillim dhe për më tepër e fal golin si ne, bëhet gjithçka e vështirë dhe skuadra goditet psikologjikisht.

Cili mund të jetë tra-

jneri i duhur për Shqipërinë?

Nuk e vendos unë trajnerin, pasi është një president dhe ndihmohet nga stafi i tij për të vendosur. Fillimisht duhet që trajneri të dijë se ka kohë të mjaftueshme në dispozicion dhe nuk duhet t'i vihen pretendime të mëdha. E dimë mirë se janë benefite për Federatën e Futbollit, por njëkohësisht e dimë mirë edhe nivelin se ku jemi. Zgjidhjet i bën presidenti.

A duhet hequr dorë nga trajnerët e huaj të'u be-shohet shqiptarëve?

Ky mentalitet nuk ka hyrë tani te ne, por që nga koha kur iku Demollari. Lojtarët binden më shumë me një trajner të huaj se me një shqiptar, por duhet të dimë se edhe shqiptari mund ta bëjë mirë punën e tij. Edhe kur u zgjodh Panuçi, presidenti është interesuar, ka pyetur, por nuk jam i bindur nëse e zgjodhi Panuçin për kushte

ekonomike, apo u besoi realisht cilësive dhe aftësi që kishte.

Sa shanse kemi për kualifikim?

Duhet patjetër një fitore ndaj Andorrës. Nuk do të jetë aspak e lehtë dhe këtu nuk flas për nivelin e skuadrave, pasi ne jemi shumë më mirë. Flas për gjendjen në të cilën të dyja skuadrat janë, pasi edhe morali ndikon shumë. Duhet parë gjërat një nga një të gjitha. Duhet stabilizuar si fillim kërkesat që kemi, e përsëris prapë. Ne kemi shumë kërkesa ndaj individëve, pa dashur të hyj këtu tek individë të veçantë. Duhet të dimë se çfarë lojtarësh kemi dhe sa duhet t'u kërkojmë, duhet të dimë sa kërkojmë nga kjo skuadër. Pastaj, ka probleme edhe me mënyrën si menaxhohen situatat dhe një ndër të ishte largimi i Agollit dhe mënyra si u largua ai. Mund të përmend edhe përjashtimin e Strakoshës, cilësitet e të cilit dihen. Nuk them se Berisha nuk bën, pasi edhe ndaj Turqisë ai nuk kishte asnjë faj. Janë dy portierë shumë të mirë, që i duhen patjetër Kombëtares.

A mund të ndikojë ky menaxhim në largimin e lojtarëve si rasti i Durmishajt?

Durmishaj nuk besoj se ka pasur problem me skuadrën apo drejtuesit. Thjesht është joshur për të luajtur me ekipin e Greqisë dhe mendoj se një ndikim të madh ka pasur edhe menaxheri i futbollistit. Unë e shoh më shumë si problem personal të futbollistit. Megjithatë, unë u uroj suksesë futbollistëve, skuadrës, trajnerëve të përkohshëm apo edhe atij që do të vijë me një kontratë tjetër.

ISH-KAPITENI

Del Piero: Ky Juventus po bën historinë

Legjenda bardhezi, Alessandro Del Piero nuk mund të rrijë pa folur për Juventusin e tij dhe e bëri këtë edhe në Bali të Indonezisë, ku ishte në kuadër të "Champions League Tour", një aktiviteti i mbështetur nga UEFA. "Ndaj Atletikos ishte një përmbysje e madhe, por kush e njeh këtë shoqëri, e kupton që nuk ishte befasia. Ky Juventus po bën historinë dhe herët a vonë, Champions-i do të mbërrijë. Ronaldo është marrë për Champions-



in, por edhe nëse nuk ia dalin, nuk është dështim", tha Del Piero. "Pinturikio" ka qenë në fushë në vitin '96, kur Juventusit fitoi Champi-

ons-in për herë të fundit, pikërisht në finalen kundër Ajaksit, me të cilin bardhezinjtë do të përballen në çerekfinale të këtij edicioni. "Atëherë ka qenë një epokë tjetër dhe futboli ishte ndryshe. Ajaksi ishte një skuadër shumë më e mirë dhe talentet e saj më pas pushtuan futbollin botëror. Megjithatë, këtë edicion më bëri përshytyje mënyra se si e eliminuan Realin, ndaj për Juventusin nuk do të jetë aspak shtëjtje", u shpreh Aleks Del Piero.


INTERI NUK NDALET

Pas Kovaçicit, gati të rrimbejë talentin 18-vjeçar

Thembra" e Akilit tek Interi është mesfusha dhe më merkatonn e verës, ky do të jetë reparti që ziklatrit do të përforcojnë. Sipas asaj që raporton "Tuttosport", drejtuesit e ekipit janë në ndjekje të lojtarit 18-vjeçar, Melih Ibrahimoglu. Futboli është nga Austria, por me origjinë turke dhe luan në qendër të mesfushës duke organizuar lojën. Ai aktivizohet në ekipin e dytë të Rapidit të Vjenës dhe do të kalojë në ekipin e parë, pasi talenti i tij është i madh. Këtë sezon ai ka luajtur 18 ndeshje dhe ka shënuar 6 gola. Gjithashtu, ka servitur plot 9 asiste për shokët e ekipit. Pas Kovaçicit, duket se Interi është i gatshëm të blejë edhe një lojtar tjetër të ri në moshë, me një perspektivë të madhe.



Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Eshhtë babëzia.
8. Burton regjisor.
11. Skllavja e Abrahamit.
12. Një dite në mbledhje.
14. Tyson i boksit.
15. Rrethojnë ringun.
17. Beson pa kufij.
19. Zola që shkroi Nana.
20. Eshhtë ankimim.
23. Pak elementarë.
24. Janë me para në bankë.
26. Matet pa kufij.
27. Janë ngrehina për reparte fabrikash.
28. Një zog i verdhë.
29. Inicialet e Moravia-s.
31. Qytet gjerman.
34. Një zonjë që ha gurë.
35. Pak analogji.
36. I ka plasur të paturpit.
37. Janë legjendat.

38. Nuk ka akoma një bebe.
39. Fillojnë mirë.
40. Janë brinjë në skuadër.
42. Shkruhet i shtati.
44. Nget edhe ajo e mirë
47. Mbahet në gisht.
48. Janë numrat 1, 3, 3...

VERTIKAL

1. Kanë shpatë të tilla.
2. Janë edhe ato polare.
3. Janë mizorët.
4. Janë male në Rusi të tilla
5. Eshhtë nusja me vello.
6. Një rreth pa ekstreme.
7. Mbyllin kuvendin.
8. Në kryt të titujve
9. Diku në qendër.
10. Markë cigaresh.
13. Janë rrefimet e të pandehurit.
14. Janë penjtë për gjerjef.
16. Mbarojnë fare.
18. Janë stitët e... provimëve.
20. Mund të jenë fotografikë të tillë.
21. Vitet pa kufij.
22. Një fjalë për tutje.
24. Brown i Kodi i Da Vinci-t.
25. Eshhtë e akuzuara... injorante
26. Baldwin aktor
27. Një pjesë e kandidatëve.
28. Krenar pa çift.
30. Grazia Cucinotta.
32. Paul këngëtar.
33. Janë pështjellat.
35. Inicialet e Moravia-s.
37. Pak makinacione.
38. Samuel bomber kamerunas.
40. Markë makine koreane.
41. Ente Kombëtare Durrës.
42. Fillojnë kurat.
43. Inicialet e Zemeckis regjisor.
45. Ekstreme në litrar.
46. Fillojnë lejen.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Satelit i Uranit.
6. Eshhtë edhe ai i Pallës.
11. Tiran pa kufij
12. Në krye të armatës.
13. Një Ibrahim violinist.
14. Qendër ditore.
15. Mund të jenë fotografikë.
17. Inicialet e Einstein.
18. Një mbishkrim në kryq.
20. Janë si vite.
21. Thurman aktore.
22. Të parat në irritim.
23. I preu Seneka.
25. Fillojnë iustrimet
26. Isaac Asimov.
27. Një Vladimir kompozitor.
28. Janë në modë.
30. Janë zyrat... qeveritare
32. Me të nxjerrin trarë.
35. Një shkop, thupër.

VERTIKAL


37. Eshhtë Shqipëria e madhe.
39. U thyen në Salamina.
40. Një raport shumë i ngushtë.
41. Nota e diapazonit.
42. Fund heroic.
43. Një top në rrjetë.
45. Gjysma alarmi.
46. Herët pa zë.
47. Sampras i tenisit.
48. Me to bëjnë triko.
49. Një gjuajje fluturimthi në tenis.
50. Janë kokrrat e lisit.
7. Lindin në kokë.
8. Gjysmë shtegu.
9. Hidhen të parat.
10. Eshhtë njeriu i përsosur.
13. Një fjalë për tutje.
15. Fundi i një samurai.
16. Mbyllën me epilog.
17. Bel i maupassant.
19. Inicialet e Redford.
23. I manifeston nxënësi i papërgatitur.
24. Në hyrje të tokës.
26. Pak impresioniste.
27. Janë metrat në sipërfaqe
29. Hapet një për ajër.
30. Gjysmë krenar.
31. Një hidrokarbur.
33. Vrau Hektorin.
34. Një film i rixhiruar.
36. Kupat pa kufij.
38. Inicialet e Nolte aktor.
41. Ullmann aktore.
43. Një brilantinë moderne
44. Hotel pa kufij.
46. Ekstremë në hall.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

MAKUTERI TIM
 AGARRENDE MIKJE
 LITARET ESO
 EMILE APELIMIRI
 ELE DEPOZITAT
 AT EKAPANONET
 ELKANARINENAM
 ESSEN DAMEANAM
 GIPAMI TE EMER
 MIKATIETETI
 KORRIKU KOLLA
 UNAZA RENDDORE

FJALËKRYQI (2)

MIRANDABISHITI
 IRRAR MADHIDI
 TOAPARATEITAE
 INRIMOTETUMAE
 IRDAMARETILIL
 TIAKOTANI OD
 MKABINETE RAR
 PURTEKE ENTINIM
 PERSETTNTIIM
 LAOTI GOLA
 IAHRTPETE RIK
 VOLEE LENDEE

SUDOKU

9			7	4				
				6		5	8	
2			3					
						6	1	5
	9		7					
				2			3	
		6	1					
3	6						7	
4	2							

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

7	1	9	8	5	3	4	6	2
3	2	5	6	4	9	8	7	1
4	6	8	2	7	1	3	5	9
8	3	4	9	1	5	7	2	6
9	5	2	3	6	7	1	8	4
1	7	6	4	2	8	9	3	5
5	8	1	7	9	6	2	4	3
6	4	7	1	3	2	5	9	8
2	9	3	5	8	4	6	1	7

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

- Disa meshkuj kanë atë që e kanë merituar, të tjerët janë të pamartuarit.
- Kushtet e mendimeve dallojnë kufijtë e ndjenjave dhe kufijtë e ndjenjave dallojnë kushtet e mendimit.
- Gjithkush sheh atë që dukesh. Pak kuptojnë atë që jeni.
- Një gënjeshtrë në momentin e duhur është 100 herë më e mirë se sa një e vërtetë në momentin e gabuar.
- Nuk me vjen inat që më gënjën, por më vjen inatë përse mendoni që besoj në ju.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

1	K	U	L	T		14	4		9		7	4	19	
8	10	5				1	4	12	2	6	7	5	10	
10	4	7				4	1	2	8	10	6	4	7	5
18						1	7	5	8	9	4	2	10	4
6	5	1				6	2	10	5	2	5		12	
	7	1				17	5		1	5	10	17	4	2
2	5	10	17	4	2				4	10	6	15	5	
8		2	8	12		15			6	10	17	5		
18	10	5	16	19		6			4	8		10	1	
6		7	5			6	11	5		9	19	6	7	
4	11	4	7	6	2	6	1	5		7	17	6		
12	5	2	5			12	1	6	15	4	2		8	

K	U	L	T	M	A	P	L	A	B			
O	R	E	K	A	S	T	I	L	E	R		
R	U	L	A	K	T	O	R	I	A	L	E	
B				K	L	E	O	P	A	T	R	A
I	E	K	I	T	R	E	T	E	S			
L	A	M	E	K	E	R	M	A	T			
T	E	R	M	A	T	A	R	I	C	E		
O	T	O	S	C	I	R	M	A				
B	R	E	D	H	I	A	I	R	K			
I	L	E	I	N	E	P	H	I	L			
A	N	A	L	I	T	I	K	E	A	M	I	
S	E	T	E	S	K	I	C	A	T	O		

Thënie të mençura

- Më mirë është të meritosh e mos të fitosh, sesa të fitosh e të mos meritosh.
- Asnjëherë mos jepni diçka që do t'ju mungojë, sepse do të fajësoni atë që e mori.
- Asnjëherë mos debato me një budalla. Një tjetër që mund të jetë duke shkruar, nuk do të dijë të bëjë diferençën.
- Nuk ka trëndafila pa gjemba, por ka gjemba pa trëndafila. Arthur Schopenhauer

